



Kanton Zürich  
Bildungsdirektion  
Volksschulamt

# Plani mësimor kornizë për Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut (HSK)

Me shpjegime për kushtet e përgjithshmetë  
mësimi



# Përmbajtja

<b>1 Qëllimi i planit mësimor kornizë</b>	<b>5</b>
Mësimi i HSK-së nga fillimet e deri më sot	5
<b>2 Nocioni dhe bazat</b>	<b>7</b>
Nocioni	7
Idetë kryesore	7
Ndërtimi dhe struktura	8
<b>3 Të kuptuarit e të mësuarit e mësimdhënies</b>	<b>10</b>
Mësimi i orientuar në kompetencë	10
Vlerësimi i orientuar në kompetencë	10
Detyrat e shtëpisë	11
Mjetet dhe materialet mësimore	11
Zgjedhja e metodës	12
Neutraliteti i mësimi	12
<b>4 Fusha lëndore "Gjuhët"</b>	<b>14</b>
Rëndësia dhe objektivat e fushës lëndore	14
Didaktika e shumëgjuhësisë	15
Fushat e kompetencës	15
<b>5 Fusha lëndore "Natyra, njeriu, shoqëria"</b>	<b>18</b>
Rëndësia dhe objektivat e fushës lëndore	18
Fushat e kompetencës	19
<b>6 Për mësimin në secilin cikël</b>	<b>23</b>
Cikli 1	23
Cikli 2	24
Cikli 3	24
<b>7 Fjalorth</b>	<b>25</b>
<b>8 Shtojcat</b>	
Shtojca I: Kushtet e përgjithshme në kantonin e Cyrihut	32
Shtojca II: Nivelet dhe temat – një vështrim i përgjithshëm	37
Shtojca III: Literatura	43

## Impressum

### Herausgeberin

Bildungsdirektion Kanton Zürich,  
Volksschulamt

Erarbeitet in Zusammenarbeit mit den  
HSK-Trägerschaften

Wissenschaftliche Beratung durch Dr.  
Ursula Ritzau, PH FHNW, und Prof. em.  
Dr. Dr. Basil Schader, PHZH

### Gestaltung

raschle & partner  
raschlepartner.ch

### Übersetzung

Interserv AG

### Kontakt

Volksschulamt, Abteilung Besondere  
Förderung Sektor Interkulturelle  
Pädagogik  
Walchestrasse 21  
8090 Zürich  
+41 43 259 53 61  
ikp@vsa.zh.ch www.zh.ch/hsk

Die Orientierung an diesem Lehrplan  
wird auch in anderen Kantonen  
empfohlen: Basel-Landschaft, Basel-  
Stadt, Bern, Glarus, Luzern,  
Schaffhausen, St. Gallen und Thurgau.



**Kanton Zürich**  
**Gemeinnütziger Fonds**

Finanzielle Unterstützung durch den  
gemeinnützigen Fonds des Kantons  
Zürich

**Vollständig überarbeitete**

**4. Auflage 2023**

© Bildungsdirektion Kanton Zürich

# Hyrje

Përkrahja e kompetencave *shumëgjuhësore* dhe *ndërkulturore* renditet ndër detyrat themelore të shkollës. Këtë qëllim e ndjek edhe mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut (HSK), i cili plotëson shërbimet e Shkollës fillore. Në këtë mësim fëmijët dhe të rinjtë *dy- dhe shumëgjuhësh* i zgjerojnë kompetencat në *gjuhën e prejardhjes* së tyre. Veç kësaj ata fitojnë njohuri mbi *mjediset jetësore* aktuale dhe mbi kulturat e prejardhjes së tyre. Mësimi i HSK-së ofrohet nga *vendet e prejardhjes* dhe nga organet përgjegjëse private. Ata marrin prej më shumë se pesëdhjetë vjetësh, përkrahje profesionale dhe administrative nga Drejtoria arsimore.

Zyra e arsimit fillor të kantonit të Cyrihut, me pjesëmarrjen e organeve përgjegjëse të HSK-së dhe të profesionistëve të tjerë të jashtëm, përpunoi në vitin 2011 një Plan mësimor kornizë për këtë mësim, i cili përdoret edhe në kantonet e ndryshme të Zvicrës gjermanishtfolëse. Qëllimi ishte që planet mësimore të ofruesve individualë të unifikohen me Planin mësimor të shkollës fillore. Përpunimi i këtij Plani mësimor kornizë merr parasysh ndryshimet në politikat arsimore, ku Plani mësimor kornizë është harmonizuar me Planin mësimor 21 të shkollës fillore. Në të njëjtën kohë, përpunimi përmban përmirësime të mëtejshme përmbajtjeje dhe gjuhësore, të cilat janë bërë në bashkëpunim me mësuesit e HSK-së, koordinatorët e HSK-së dhe profesionistë të tjerë të jashtëm.

## Për ndërtimin e këtij publikimi

Plani mësimor kornizë orientohet në Planin mësimor 21 të shkollës fillore. Për këtë arsye, disa pjesë të tekstit nga Plani mësimor 21 janë marrë drejtpërdrejt ose janë përshtatur pak për këtë botim. Kapitulli 1 shpjegon kuptimin dhe qëllimin e Planit mësimor kornizë dhe jep një pasqyrë të mësimi të HSK-së nga fillimet e deri në ditët e sotme. Kapitulli 2 përshkruan bazat, kapitulli 3 merret me të kuptuarit e të mësuarit dhe të mësimdhënies. Kapitujt 4 dhe 5 u kushtohen dy fushave lëndore "Gjuhët" dhe "Natyra, njeriu, shoqëria" Këtu përfshihen së pari rëndësia e këtyre fushave lëndore dhe pastaj përcaktohen fushat e kompetencës përkatëse me gjithë kompetencat. Secili nga organet përgjegjëse ose mësuesit e HSK-së i hartojnë vetë metodikat e ndërtimit të kompetencës. Për këtë arsye kapitulli 6 kufizohet në mendime të përgjithshme për secilin nga ciklet.

Fjalorthi (kapitulli 7) është marrë në kryesisht nga Plani mësimor kornizë i mëparshëm. Disa modifikime janë marrë duke u bazuar në fjalorthin e botimit të DKE-së "Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut HSK" (Anja Gidici, Regina Bühlmann 2014). Fjalorthi shpjegon të gjitha nocionet që janë me shkronja *të pjerrëta* në këtë tekst. Përkufizimet më të rëndësishme janë si vijon: Gjuha e cila mësohet në mësimin e HSK-së është për shumicën e fëmijëve *gjuha e parë* e tyre, por për disa të tjerë *gjuha e dytë*. Ky plan mësimor e përcakton gjuhën e shkollës në mësimin e HSK-së si *gjuhë e prejardhjes*.

Shtojca (kapitulli 8) përmban bazat ligjore të mësimi të HSK-së në kantonin e Cyrihut si dhe udhëzime të Zyrës së arsimit fillor mbi zbatimin e tyre. Bashkëngjitur është edhe një pasqyrë e temave të mundshme për çdo nivel dhe literaturë të përmendur në tekst.



# 1 Qëllimi i Planit mësimor kornizë

Ky Plan mësimor kornizë i përshtat objektivat e kurseve të HSK-së me nevojat aktuale të fëmijëve *dy-ose shumëgjuhësh* dhe është i harmonizuar me Planin mësimor 21. Qëllimi i përdorimit është i trefishtë:

Së pari, Plani mësimor kornizë u shërben organeve përgjegjëse të HSK-së për t'i zhvilluar edhe më tutje planet e tyre mësimore dhe për t'i koordinuar me Planin mësimor 21. Prandaj, pozicionet fillestare janë të ndryshme: Organet përgjegjëse që krijojnë për herë të parë një shërbim mësimor, mund ta përdorin këtë plan si orientim për krijimin e planeve të tyre mësimore. Organet përgjegjëse shtetërore, nga ana tjetër, kanë tashmë plane mësimore të përcaktuara nga ministritë arsimore të vendeve përkatëse të prejdardhjes. Nëse është e nevojshme ata i përshtatin përmbajtjet e këtyre planeve mësimore në mënyrë që të jenë në përputhje me objektivat dhe përmbajtjet e Planit mësimor kornizë të HSK-së dhe jo në kundërshtim me të. Të gjithë organet përgjegjëse kanë një liri veprimi për të peshuar çdo kompetencë dhe fushë lëndore të Planit mësimor kornizë, sipas nevojave dhe kërkesave të tyre. Duke qenë se ata kanë në dispozicion për mësimin vetëm dy deri në katër orë leksione në javë dhe grupet mësimore sa i përket grupmoshave, njohurive paraprake dhe nivelit të aftësive janë kryesisht heterogjene, atëherë duhet t'i vendosin vetë prioritetet.

Së dyti, Plani mësimor kornizë i shërben Drejtorisë arsimore si bazë për shqyrtimin e një kërkesë të një organi përgjegjës të HSK-së për njohjen e kursit të tyre. Njihen vetëm ato kurse të organeve përgjegjëse, planet mësimore dhe mësimi i të cilëve korrespondojnë me Planin mësimor kornizë. Nëse ka një plan mësimor të vendit të prejdardhjes, duhet të shpjegohet se si përshtatet ai plan me Planin mësimor kornizë i HSK-së dhe çfarë parashihet në rast të mospërshtatjes. Nëpërmjet këtij funksioni në procesin e njohjes, ky Plan mësimor kornizë është i detyrueshëm për organet përgjegjëse, kurset e të cilëve janë të njohura. Ai përcakton kornizën brenda së cilës ata mund të vendosin objektivat dhe përmbajtjet e tyre specifike në planin e tyre mësimor dhe t'i përfaqësojnë ato në mësimin e tyre.

Së treti, Plani mësimor kornizë u shërben të gjithëve si bazë komunikimi: Ai u ofron organeve përgjegjëse, mësuesve të HSK-së, institucioneve lokale e kantonale si dhe institucioneve arsimore një bazë të përbashkët për kushtet, objektivat, përmbajtjet dhe nocionet e mësimin të HSK-së.

Ky Plan mësimor kornizë është i bazuar në kushtet dhe kërkesat aktuale në kantonin e Cyrihut. Me "Planin mësimor 21" është menduar me Planin mësimor 21 të Cyrihut.

## Mësimi i HSK-së nga fillimet e deri më sot

Me iniciativën e refugjatëve politikë nga Italia, në vitet 1930 HSK, filluan kurset e para në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut () në kantonin e Cyrihut. Me rritjen e emigracionit italian, numri i këtyre kurseve u shtua gjithnjë e më tepër. Në përfundim të viteve 1960 dhe në fillim të viteve 1970, zhvilluan shërbime analoge edhe shoqatat e prindërve të kombësive të tjera. Gjithnjë e më tepër organizimi i tyre u mor përsipër nga *vendet* përkatëse të *prejdardhjes*. Këshilli Edukativ (sot Këshilli Arsimor) lejoi më 21 qershor 1996 në një vendim të parë për këtë temë, që të provohen këto kurse në ambientet e shkollave. Hë për hë kjo vlente vetëm për mësimin e italishtes, i cili nuk mund të mbahej ende gjatë "orarit të rregullt shkollor".

Në një vendim të 16 majit 1972, Këshilli Edukativ u la duar të lira komunave shkollore që t'i integrojnë në orarin e rregullt shkollor kurset e HSK-ve të italishtes dhe të spanjishtes. Në të njëjtin vit, konferenca zvicerane e Drejtorëve Kantonalë të Edukimit (DKE), këshilloi që të lejohen dy orë mësimi të HSK-së në javë, brenda orarit të rregullt shkollor.

Në vitin 1982 konsullatat e përgjithshme italiane dhe spanjolle si dhe "Grupi koordinues i shoqatave të bashkuara të prindërve emigrantë në kantonin e Cyrihut" kërkuan nga Këshilli i Edukimit që t'i integrojnë në

sistemin shkollor në tërë kantonin kurset e HSK-së dhe të lejojë që nota e HSK-së të shënohet edhe në dëftesë. Me vendimin e datës

8 nëntor 1983, Këshilli i Edukimit i mori parasysh këto dëshira dhe i lejoi kurset e të gjitha kombësive në formë prove. Ky rregullim i ri ua rriti vlerën kurseve dhe i bëri më të njohura. Njëkohësisht, ofruesit e kurseve, institucionet e Cyrihut dhe personeli arsimor i shkollës së rregullt filluan të bashkëpunojnë në mënyrë më të koordinuar (zhvillimi i planeve dhe mjeteve mësimore specifike për HSK-në, arsimime të mëtejme, projekte pilot). Pas një faze eksperimentuese tetëvjeçare rezultoi një rregullore mbi "Zhvillimin e Kurseve të Gjuhës dhe Kulturës së Atdheut", të cilën Këshilli i Edukimit e miratoi më 11 qershor 1992. Ky vendim e nguliti mësimin në Shkollën fillore të Cyrihut. Kjo rregullore mundësoi për herë të parë njohjen e kurseve të organeve përgjegjëse joqeveritare. Në ligjin e Shkollës fillore të vitit 2005 dhe në rregulloren e vitit 2006 mësimi i HSK-së u vendos mbi një bazë të re ligjore.


Në vitet 1980, krahas Italisë dhe Spanjës, kursin e HSK-së e ofronin vetëm Jugosllavia, Turqia, Greqia dhe Portugalia. Prej viteve 1990 u rrit numri i ofruesve të kurseve dhe sot kurset e njohura të HSK-së ofrohen në 31 gjuhë.

Numri i nxënësve në vitin shkollor 2009/10 për herë të parë ishte mbi 10 000. Numri i pjesëmarrësve është i ndryshëm në varësi të gjuhës dhe lidhet me faktorë të ndryshëm, si madhësia e grupit të gjuhës, situata organizative dhe financiare e organit përgjegjës, përkrahja e vendit të prejardhjes etj.

Format organizative të mësimin të HSK-së shpërfaqin ndryshimet e organeve përgjegjëse dhe komuniteteve gjuhësore, për shembull, në lidhje me të kuptuarit e arsimit, arsyet për emigrim ose arratisje, përvoja historike ose mënyra si shihet jeta në Zvicër.

Fillimisht mësimi i HSK-së kishte për qëllim të shërbente para se gjithash për një kthim të mundshëm në *vendin e prejardhjes* në mënyrë që ta lehtësojë (ri-)integrimin në shkollë. Në vazhden e kohës ndryshoi sfondi i nxënësve dhe me këtë edhe objektivat e mësimin. Duke qenë se vetëm një pjesë e vogël e nxënësve po kthehej në *vendin e prejardhjes*, ndryshoi qëllimi i mësimin në mënyrë që të përkrahen fëmijët e gjeneratës së parë dhe të gjeneratës së dytë të emigrimit në *integrimin* e tyre në shoqërinë e këtushme. Përveç kësaj, mësimin filluan ta vijojnë edhe fëmijët e familjeve me dy shtetësi, për të cilët as *integrimi* dhe as "kthimi" nuk janë një temë e rëndësishme.

Për të gjithë nxënësit u forcua në të njëjtën kohë përkrahja e *shumëgjuhësisë* gjegjësisht përkrahja e *gjuhës së prejardhjes* si një synim i pavarur dhe më i rëndësishëm. Në këtë mënyrë rrjedh njohuria nga praktika pedagogjike dhe hulumtimi, se *shumëgjuhësia* krijon një potencial në mësim. Me nxitjen e saj përfiton jo vetëm individi por edhe e tërë shoqëria. Në kantonin e Cyrihut plot 43% e nxënësve të shkollës fillore flasin një tjetër *gjuhë të parë* që nuk është gjermanishtja (Statistika arsimore e kantonit të Cyrihut, botimi i 2020). Ky potencial i *shumëgjuhësisë* vlen për t'u nxitur dhe shfrytëzuar.



## 2 Nocioni dhe bazat

### Nocioni

Në mësimin e Gjuhës dhe *Kulturës* së Atdheut, fëmijët dhe të rinjtë e zgjerojnë kompetencën e tyre në *gjuhën e prejardhjes* jogjermane. Këtu bëhet fjalë për *gjuhën e parë* - ose *të dytë*. Përveç kësaj, nxënësit i thellojnë njohuritë e tyre për kulturat dhe *mjediset jetësore* të tyre, veçanërisht për kulturën, historinë, letërsinë, gjeografinë dhe traditat e vendit të prejardhjes së familjes së tyre. Ata merren me situatën e tyre dhe kështu e zgjerojnë aftësinë e tyre për t'u orientuar në shoqëri të ndryshme, qoftë kjo në Zvicër ose në *vendet e prejardhjes*. Nëpërmjet mësimin ata përkrahen në mënyrë gjithëpërfshirëse në zhvillimin e tyre gjuhësor, njohës, social dhe emocional.

Në mënyrë që të mos ketë ngatërresa në lidhje me bazën ligjore, emërtimi "Gjuha dhe Kultura e Atdheut" do të ruhet në Planin mësimor edhe pse në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës është i pasaktë: Vetëm për një pakicë e fëmijëve dhe të rinjve që e ndjekin këtë mësim, *vendet e prejardhjes* së tyre janë qartësisht dhe ekskluzivisht atdheu i tyre. Për më tepër, shumica ka lindur në Zvicër dhe lëviz në *mjedise jetësore* dhe *kultura* të ndryshme.

### Idetë kryesore

- Mësimi i HSK-së i përkrah nxënësit në *gjuhën e prejardhjes* në përputhje me moshën, njohuritë paraprake dhe nivelin e arritjeve të tyre.
- Mësimi korrespondon me vlerat e formuluar në Planin mësimor 21 tek kapitulli "Bazat" nën "Objektivat arsimore" si orientim për shkollën, veçanërisht me sa vijon:
  - › "Shkolla është neutrale në raport me politikën, besimet fetare dhe konfesionet.
  - › Shkolla përkrah mundësitë e barabarta.
  - › Shkolla përkrah barazinë gjinore.
  - › Shkolla kundërshton të gjitha format e diskriminimit.
  - › Shkolla zgjon dhe përkrah mirëkuptimin për drejtësinë sociale, demokracinë dhe mirëmbajtjen e mjedisit natyror.
  - › Shkolla përkrah respektin e ndërsjellë në të jetuarit së bashku me njerëzit e tjerë, veçanërisht sa i përket *kulturave* besimeve fetare, formave të jetesës.
  - › Shkolla niset nga parakushtet e ndryshme mësimore të fëmijëve dhe të të rinjve dhe merret në mënyrë konstruktive me shumëllojshmërinë.
  - › Shkolla kontribuon në kohezionin social në një shoqëri pluraliste."
- Mësimi forcon ndërgjegjësimin se *dy- apo shumëgjuhësia* krijon një potencial shtesë që nxënësit mund ta shfrytëzojnë. Ai e vlerëson pozitivisht shumëgjuhësinë e konsideruar si një e mirë shoqërore.
- Mësimi i mbështet fëmijët dhe të rinjtë në trajtimin e *koncepteve identitare* të ndryshme, të cilat rrjedhin nga përkatësitë, *kulturat*, traditat dhe historitë e ndryshme. Këtu përvojat individuale dhe njohuritë si për *vendin e prejardhjes* ashtu edhe për Zvicrën merren, thellohen dhe reflektohen. Këtu përfshihen pikëpamjet për vlerat dhe normat, historinë apo besimet fetare. Dhënia e mësimave të besimit fetar dhe ideologjive politike (partiake) nga ana tjetër nuk i përket fare mësimin.
- Mësimi i përkrah nxënësit në aftësinë e tyre për t'u marrë me konfliktin, në *kompetencat ndërkulturore* dhe në aftësinë e tyre për të gjykuar. Ai përkrah një qëndrim të hapur, jodiskriminues dhe plot respekt

ndaj njerëzve të tjerë.

- Mësimi e përkrah *integrimin* e fëmijëve dhe të rinjve me *prejardhje migrimi* në shkollën fillore.
- Mësimi krijon parakushtet që nxënësit të mund t'i përdorin *kompetencat e tyre shumëgjuhësore* dhe *ndërkulturore* në arsimimin e mëvonshëm dhe në punë, si në Zvicër ashtu edhe në *vendet e prejardhjes*.
- Mësimi i përkrah nxënësit në komunikimin me njerëzit që flasin të njëjtën gjuhë në Zvicër dhe në *vendet e prejardhjes*.
- Mësimi i përkrah nxënësit që të jenë në gjendje të përdorin media dhe letërsi të përshtatshme për moshën në *gjuhën e prejardhjes* së tyre.
- Mësimi nisat nga përvojat dhe interesat e fëmijëve dhe të rinjve dhe zgjon interesa të reja. Sipas mundësisë, ai i vë ata në kontakt të drejtpërdrejtë me përmbajtjen mësimore dhe lidh të mësuarit e tyre me aktivitetet e tyre gjuhësore, duke përfshirë ndër të tjera përdorimin e mediave elektronike në mësim (faqet e internetit dhe mediat sociale në *gjuhën e prejardhjes* etj.).  
Hapat në të mësuar dhe detyrat u përgjigjen gjendjes së secilit nxënës.
- Mësimi u jep hapësirë elementeve të lojës dhe komunikimit gojor. Në kopshtin parashkollor qasja është parimisht përmes lojës.
- Mësimi i shfrytëzon mundësitë të cilat rrjedhin nga fakti që nxënësit lëvizin në një masë të caktuar në *mjedise* të ndryshme gjuhësore dhe *jetësore*. Andaj ai merr rregullisht përvojat individuale të nxënësve dhe kultivon krahasimin si princip bazë didaktik. Nëpërmjet krahasimit të *gjuhës së prejardhjes* me gjermanishten dhe krahasimin e *dialektit(eve)* si dhe gjuhës standarde në gjermanisht e po ashtu edhe *variantit standard* të *gjuhës së prejardhjes*, mësimi i thellon kompetencat në gjuhët përkatëse. Nëpërmjet krahasimit të *mjediseve jetësore* të ndryshme, ai e thellon të kuptuarit e ngjashmëri, dallimeve dhe veçorive të rëndësishme.

## Ndërtimi dhe struktura

Meqenëse Plani mësimor kornizë i HSK-së orientohet në Planin mësimor 21 dhe merr strukturën dhe terminologjinë e tij, këtu do të sqarohet shkurtimisht ndërtimi i Planit mësimor 21. Shpjegime të hollësishme gjenden në kapitujt

"Përmbledhje" dhe "Bazat" të Planit mësimor 21.

### Plani mësimor 21: Ciklet dhe struktura

Plani mësimor 21 i ndan njëmbëdhjetë vitet e detyrueshme shkollore në tri cikle. Cikli i parë përfshin dy vite të kopshtit parashkollor dhe dy vitet e para të shkollës fillore (deri në fund të klasës së 2-të). Cikli i dytë përfshin katër vite të shkollës fillore (klasa e 3-të deri në të 6-n) dhe cikli i tretë janë tri vitet e shkollës sekondare (klasa 7-të deri 9-tën).

Plani mësimor 21 është i renditur në gjashtë fusha lëndore: Gjuhët; matematika; natyra, njeriu, shoqëria (NNJSH); modelimi; muzika si dhe stërvitja dhe sporti. Për secilën fushë lëndore përshkruhen *kompetencat* që fitojnë nxënësit gjatë shkollës fillore. Përveç kësaj, Plani mësimor përmban modulet mbilëndore "Media dhe informatika" si dhe "Orientimi profesional". Në fushat



dhe modulet e planeve mësimore janë përpunuar kompetencat mbilëndore (personale, sociale dhe metodike) si dhe temat mbilëndore nën parimin udhëzues të Formimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm (FZHQ)


### **Plani mësimor 21: Ndërtimi i kompetencave**

Çdo fushë lëndore e Planit mësimor 21 është e ndarë në *fusha të kompetencës*. Për shembull fushat lëndore gjermanisht, anglisht, italisht dhe frëngjisht ndahen secila në "të dëgjuarit", "të folurit", "të shkruarit", "gjuha(ët) në fokus" gjegjësisht "kulturat në fokus" (fusha lëndore anglisht, italisht, frëngjisht). Në secilën *fushë të kompetencës* formulohen *kompetenca* të ndryshme dhe paraqitet ndërtimi i tyre. Për secilën kompetencë përshkruhet ndërtimi i pritshëm në njohuri dhe aftësi për cikël në shkallë të ndryshme. Këto *shkallë kompetencash* shprehin faktin se kompetencat fitohen vazhdimisht për një periudhë të caktuar kohore.

### **Plani mësimor i HSK-së: Struktura dhe ndërtimi i kompetencave**

Në këtë Plan mësimor kornizë mungon një nënndarje e fitimit të kompetencave për secilin cikël dhe nivelet e kompetencës. Është detyrë e secilit trup administrativ të HSK-së që kompetencat specifike dhe përmbajtjet përkatëse t'i përcaktojnë në mënyrë që mësuesit e HSK-së të mund ta përgatitin konkretisht mësimin e tyre.

# 3 Të kuptuarit e të mësuarit- e mësimeve



Pasqyrimi 1: Përvetësimi i kompetencave (krahaso Planin mësimor 21, kapitullin "Kuptimi i të mësuarit dhe mësimeve").

## Mësimi i orientuar në kompetencë

Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut orientohet sikurse Plani mësimor 21 në kompetenca dhe përvetësimin e kompetencave. Fokusi qëndron në atë se cilat njohuri, cilat zotësi dhe shkathtësi duhet të përvetësojnë nxënësit në fushat lëndore dhe ato të kompetencave. Kompetencat përfshijnë disa aspekte të lidhura me përmbajtjen dhe procesin: zotësitë, shkathtësitë dhe njohuritë, por edhe gatishmëritë, qëndrimet dhe pikëpamjet. Me këtë të fundit, përveç aspekteve të lidhura me kulturën, trajtohen para së gjithash edhe dimensionet e të mësuarit, bazuar në përgjegjësitë individuale, kooperim, motivim dhe gatishmëri për përparim.

Kompetencat që do të përvetësohen janë si të natyrës lëndore ashtu edhe të asaj mbilëndore. Kompetencat lëndore përshkruajnë njohuritë specifike lëndore dhe zotësitë e shkathtësitë e lidhura me to. Kompetencat mbilëndore sqarojnë ato njohuri dhe aftësi që luajnë një rol me rëndësi për të mësuarit në tërësi. Këtu përfshihen kompetencat personale, sociale dhe metodike.

Tek mësimi i orientuar në kompetencë, përmbajtjet mësimore zgjidhen dhe përpunohen në aspektin didaktik-metodik në mënyrë që nxënësit të mund t'i përvetësojnë dhe t'i përforcojnë kompetencat e dëshiruara. Në bazë të Planit mësimor kornizë të HSK-së dhe të mjeteve mësimore, mësuesi i HSK-së shohet se cilat objektiva të kompetencave nëpërmjet cilave përmbajtje lëndore dhe tema mund të realizohen. Mbi këtë bazë, ai/ajo organizon mjedisin mësimor dhe njësitet mësimore në mënyrë që nxënësit të mund t'i përvetësojnë kompetencat përkatëse. Këtu, ai/ajo i kushton vëmendje të lartë kushteve paraprake në grupin mësimor.

## Vlerësimi i orientuar në kompetencë

Tek mësimi i orientuar në kompetencë bën pjesë një kulturë feedback-u që lidhet me arritjen e objektivave të kompetencave. Feedback-u konstruktiv është një tipar kyç i cilësisë së mëimit, i cili e përkrah të mësuarit dhe përvetësimin e kompetencave. Nxënësit vlerësohen në aspektin formues (proces përcjellës: udhëzime të orientuara në përkrahje, çfarë mund të përmirësohet në rastin tjetër), përmbledhës (proces përmblyës, balancim) dhe gjithashtu prognostik (i drejtuar nga e ardhmja: vlerësimi nëse janë plotësuar parakushtet për mësimin e mëtejshëm në një fazë tjetër të të mësuarit apo niveli shkollor).

Prej klasës së 2-të nxënësit marrin një notë për arritjet dhe përparimet në mësimin e HSK-së

Mësuesit e HSK-së së kurseve të njohura të HSK-së e vendosin këtë notë në përfundim të secilit semestër, për secilin fëmijë në një certifikatë. Mësuesi përkatës i klasës e bart këtë notë në dëftesën e shkollës fillore të Cyrihut. Në kopshtin parashkollor dhe në klasën e parë fëmijët nuk marrin nota. Megjithatë, mësuesit e HSK-së mund t'u japin prindërve në një bisedë të dhëna mbi përparimin e fëmijës së tyre.

### **Kompetencat mbilëndore (kompetencat që shtrihen në më shumë lëndë)**

Notat japin informacion se në cilën shkallë një nxënës në mësimin e HSK-së i ka arritur kompetencat e synuara dhe çfarë përparimesh në të mësuar janë realizuar. Me vullnet të lirë, mësuesi i HSK-së mund t'i vlerësojë në certifikatën e kursit secilën nga fushat e kompetencave. Për ciklin 1 dhe 2 janë këto: Të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit, gjuha(ët) në fokus, letërsia në fokus si dhe Natyra, njeriu, shoqëria (NNJSH) Për ciklin 3 janë këto: Të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit, gjuha(ët) në fokus, letërsia në fokus si dhe Natyra dhe teknika (NT)/ Ekonomia, puna, ekonomia shtëpiake (EPESH) / Hapësirat, kohët, shoqëritë (HKSH) / Besimet fetare, kulturat, etika (BFKE).

Vlerësimi me nota lidhet me objektivat e planeve mësimore që janë hartuar nga organet përgjegjëse të kurseve ose janë ofruar nga ministritë arsimore të *vendeve të prejardhjes* dhe duhet të orientohen në kompetencat e këtij Plani mësimor. Nota jep një informacion për sukseset në lëndët mësimore dhe kompetencat, jo për sjelljen, për kujdesin apo për përpikërinë. Tek vlerësimi i performancës dhe dhënia e notave vlen shkalla e njëjtë e notave si në shkollën fillore të Cyrihut.

Nota vlerëson performancën e përgjithshme të një fëmije apo të riu në mësim. Ajo nuk pasqyron vetëm arritjet në provimet formale, por përfshin edhe vëzhgimet e mësuesit të HSK-së për arritjet në lëndët mësimore (për shembull të shprehurit me gojë, vëzhgimet për procesin e të nxënësve etj.). Si rrjedhojë, ajo nuk është vetëm rezultat i mesatares së provimeve.

Mësuesit e HSK-së e përkrahin sipas kërkesës edhe mësuesin e klasave të rregullta gjatë vlerësimit të nxënësve (veçanërisht në raport me vendimet për shkollimin e mëtejshëm).

### **Detyrat e shtëpisë**

Detyrat e shtëpisë mund të mbështesin proceset mësimore, duke ofruar një mundësi për t'u marrë jashtë procesit mësimor me përmbajtjet mësimore. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të kenë mundësi t'i zgjidhin detyrat e shtëpisë pa ndihmën e drejtpërdrejtë të prindërve. Megjithatë, mund të jetë me vlerë që të përfshihen kompetencat e prindërve në gjuhën e prejardhjes, si për shembull, për detyrat me dialogë apo në formë loje. Për më tepër, pritjet që prindërit të interesohen për mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre në mësim. Kjo mund të nxitet nëpërmjet bashkëpunimit të mirë me prindërit, për shembull, në mbrëmjet me prindër ose në vizitat në shkollë. Gjatë dhënies së detyrave të shtëpisë, mësuesit e HSK-së marrin parasysh aftësitë dhe moshën e nxënësve. Kështu ata e mënjanojnë mbingarkesën e tyre dhe i motivojnë me sfida të përshtatshme.

### **Mjetet dhe materialet mësimore**

Mjetet dhe materialet mësimore përzgjidhen nga organet përgjegjëse të HSK-së dhe vihen në dispozicion. Ato marrin parasysh aftësitë dhe ndryshme mësimore dhe objektivat e kompetencave si dhe situatat specifike (*dy-ose shumëgjuhësia*, , përvoja emigrimi) të nxënësve. Ato ndihmojnë në përmirësimin e kërkesave të Planit mësimor nëpërmjet asaj që drejtohet sipas tij. Krahas materialeve mësimore tradicionale (libra, fletore pune etj.) duhet të përdoren edhe mediat elektronike (filma online, viedeotelefonia, media sociale etj.).

## Zgjedhja e metodës

Gjatë organizimit të mësimin, mësuesit e HSK-së janë të lirë në zgjedhjen e metodës në kuadër të parimeve didaktike të Planit mësimor kornizë. Ata zgjedhin metodën, e cila në situata të caktuara mësimore i përgjigjet më së miri qëllimeve të kompetencave dhe përmbajtjeve si dhe të nxënësve dhe vetë atyre. Ata marrin parasysh që të zbatojnë një mori metodash, si udhëzime të drejtpërdrejta, të mësuarit zbulues, punë planifikimi, mësim projekti, punë në të mësuarit në partneritet etj.

Zgjedhja e metodës i përgjigjet rrethanave, pasi përbërja e grupit të nxënësve është shpesh heterogjene: Ata vijnë nga klasa ose shkolla të ndryshme, i përkasin moshave të ndryshme, kanë një të kaluar biografike të ndryshme dhe një gjendje të ndryshme gjuhësore në gjuhën e parë dhe në të dytën.

## Neutraliteti i mësimin

Mësimi i HSK-së është asnjans në aspektin politik dhe konfesional. Ai nis nga një botëkuptim pluralist dhe heq dorë nga çdo indoktrinim politik dhe nacionalist.

Mësimi merret me interpretime të ndryshme të ngjarjeve historike (krahaso këtu kapitullin "Udhëzime didaktike për hapësirat, kohët, shoqëritë" në Planin mësimor 21): Faktet historike mund të kontrollohen. Nga ana tjetër, interpretimi i fakteve varet nga perspektivat, vendet dhe interesat.

Nëse mësimi i HSK-së merret me temën e besimeve fetare, qëllimi është njohuria për besimet fetare dhe jo pranimi i një besimi të caktuar ose kryerja e riteve fetare. Mësimi përkrah një qëndrim të paanshëm, të hapur dhe një qasje jodiskriminuese ndaj besimeve fetare dhe botëkuptimeve (krahaso këtu kapitullin "Udhëzime didaktike për etikën, besimet fetare, shoqëritë" në Planin mësimor 21).

Asnjansia e mësimin është plotësuar kur, për shembull, prezantohet himni kombëtar i një vendi, diskutohet përmbajtja dhe përfshihet në aspektin historik. Në anën tjetër, asnjansia e mësimin cenohet nëse himni kombëtar këndohet bashkërisht para fillimit të çdo mësimi, kur përkrahet një *identitet* i njëanshëm si dhe kur promovohet në mënyrë të vetëdijshme krenaria kombëtare.



## 4 Fusha lëndore "Gjuhët"

### Rëndësia dhe objektivat e fushës lëndore

#### Varianti standard (letrar) dhe reflektimi gjuhësor

Mësimi i HSK-së zhvillohet në variantin standard të gjuhës përkatëse. Aty ku kjo ende nuk është e mundur, për të siguruar të kuptuarit, mund të përdoren variante *dialektore* dhe/ose gjermanishtja. Mësimi përfshin njohuritë paraprake të gjuhës së prejardhjes së fëmijëve, të cilat dallohen individualisht shumë dhe gjithashtu mund të përmbajnë forma *dialektore*.

Njohja e *variantit standard* është e domosdoshme për përdorimin e gjuhës mbirajonale dhe për lidhjen me kulturën e të shkruarit të *vendeve të prejardhjes*. Këtij qëllimi i shërbejnë edhe dhënia e njohurive nga gramatika, drejtshkrimi si dhe format e reflektimit dhe krahasimit gjuhësor sipas moshës. Nxënësit nxiten që në bazë të përmbajtjeve motivuese mësimore, të mendojnë mbi aspekte të ndryshme të *gjuhës së tyre të prejardhjes* (p.sh. *dialektet* dhe dallimet e tyre, zhvillimi i gjuhës, fjalë të huaja nga anglishtja dhe të tjera, dallimet strukturore dhe analogjitë me gjermanishten dhe gjuhët tjera të cilat mësohen në shkollë).

Puna në leksik (përfshirë këtu shprehjet dhe dhënien e modeleve të fjalive etj.) i aftëson ata për t'u shprehur ashtu siç duhet në situata të ndryshme dhe për tema të ndryshme.

Nxënësit përjetojnë shpesh dhe drejtpërdrejt se si mund ta përdorin gjuhën e folur dhe të shkruar. Mësuesit e HSK-së përfshijnë për këtë propozimet e tyre si dhe ngjarjet aktuale. Ata e përkrahin interesin e tyre për *variantin standard të gjuhës së prejardhjes* nëpërmjet një përdorimi kreativ të teksteve të zgjedhura letrare si dhe situatave autentike motivuese të të shkruarit në mediat konvencionale dhe të reja.

#### Heterogjeniteti

Mësimi merr parasysh faktin se kompetencat e gjuhës së prejardhjes së nxënësve të HSK-së mund të jenë shumë heterogjene. Kjo ka të bëjë, për shembull, me kompetencat në të folur, shtrirjen e leksikut, besimin në *variantin standard të gjuhës së prejardhjes*, përvojat në të lexuar dhe në të shkruar, në kompetencat gramatikore dhe drejtshkrimore. Për t'u marrë në mënyrë të përshtatshme me këtë heterogjenitet, mësuesi e diferencon respektivisht dhe e individualizon atë në mësim dhe në kërkesa.

#### Krahasimet gjuhësore

Fëmijët dhe të rinjtë e zgjerojnë të kuptuarit e tyre gjuhësor dhe vetëdijen e tyre gjuhësore (*vetëdija gjuhësore*), ku në bazë të parakushteve gjuhësore, *gjuhën e prejardhjes* e krahasojnë me gjermanishten dhe eventualisht me gjuhët e huaja që mësohen në shkollë. Të kuptuarit e analogjive dhe dallimeve mes *gjuhës së prejardhjes* dhe gjermanishtes, respektivisht gjuhëve të tjera që jepen ose fliten në shkollë, i ndihmon ata që të fitojnë orientim dhe siguri. Veçanërisht të frytshme janë projektet e krahasimit të gjuhëve, nëse ato realizohen në bashkëpunim me mësuesit e klasës së rregullt.

#### Kompetencat gjuhësore mbilëndore dhe specifike lëndore

Nxënëset i zhvillojnë në *gjuhën e tyre të prejardhjes* jo vetëm shkathësitë bazë të komunikimit të cilat i njohin nga përditshmëria, por përvetësojnë edhe kompetenca mbilëndore dhe specifike lëndore të cilat janë thelbësore për lloje të ndryshme të teksteve dhe për të mësuarit konjitiv në shkollë. Kompetencat mbilëndore shërbejnë për të kuptuar dhe formuluar rrethana komplekse dhe abstrakte, për të njohur lidhjet shkakore ose për të strukturuar një tekst personal. Kompetencat gjuhësore lëndore specifike përfshijnë terma, koncepte dhe formulime, të cilat karakterizojnë fushat lëndore të caktuara.

### Shkrimi

Në shkollën fillore të gjithë fëmijët dhe të rinjtë alfabetizohen në gjermanisht dhe në alfabetin latin. Në mësimin e HSK-së nxënësit përkatës mësojnë gjithashtu shkrimin në *gjuhën e prejardhjes* së tyre. Nëse aty mësohet një lloj tjetër i të shkruarit, dy proceset e të përvetësuarit ndodhin kryesisht në mënyrë të pavarur dhe nuk duhet të koordinohen ngushtë. Nga ana tjetër, nëse në mësimin e HSK-së mësohet alfabeti latin, grek ose cirilik, mësuesi i HSK-së duhet ta përfshijë edhe alfabetizimin gjerman në shkollën fillore, në mënyrë që të mënjanohej konfuzionet në proceset e të mësuarit. Ai/ajo duhet t'i njohë dhe prezantojë dallimet me alfabetin gjerman. Nëse hyrja bëhet në të dy gjuhët njëkohësisht (alfabetizimi dygjuhësor), ai/ajo informohet mbi gjendjen dhe metodën e alfabetizimit në klasat e rregullta të fëmijëve përkatës. Sipas mundësisë, ai/ajo konsultohet me mësuesit përkatës të klasave të rregullta.

### Didaktika e shumëgjuhësisë

Në mësimin e HSK-së si dhe në mësimin e gjuhës në shkollën e rregullt nuk synohet arsimimi perfekt në *dy- ose shumëgjuhësi*, por arsimimi i *shumëgjuhësisë funksionale*. Në udhëzimet didaktike për kapitullin "Gjuhët" Plani mësimor 21 përcakton qartë se çfarë është menduar me këtë: "*Shumëgjuhësia funksionale*" synon një repertor të shumëllojshëm, dinamik me kompetenca të ndryshme të përparuara në fusha të ndryshme të kompetencave ose gjuhëve, në mënyrë që të jetë e mundur të veprohet me sukses në situata të ndryshme. Kur mësojnë një gjuhë, nxënësit rikthehen në atë që kanë mësuar dhe kështu e zgjerojnë në mënyrë efektive repertorin e tyre.

Një repertor shumëgjuhësor përbëhet nga dy ose më shumë gjuhë që përdoren në domene të ndryshme (për shembull në shkollë, në kohën e lirë, në familje) dhe ndikohen në mënyra të ndryshme dhe përdoren në varësi të partnerit bisedues, partneres biseduese ose rrethanave. Shpesh një gjuhë është mbizotëruese dhe përdoret nga një nxënës në mënyrë më kompetente, më me qejf dhe më shpesh se gjuha(ët) tjetër(ra), megjithëse dominimi mund të zhvendoset me kalimin e kohës. Në shumë raste, gjuha e prejardhjes ose e familjes është dominuese deri në fillimin e shkollës, ndërsa gjuha gjermane gjatë kohës së shkollës fiton më shumë rëndësi për nxënësin dhe eventualisht bëhet mbizotëruese. Parimisht personat shumëgjuhësor nuk i mbajnë rreptësisht të ndara gjuhët dhe domenet e tyre gjuhësore, por kthehen tek repertori i përgjithshëm i tyre gjuhësor dhe e përdorin gjuhën e tyre në mënyrë strategjike dhe fleksibël.

"Përzierjet gjuhësore" mes *gjuhës së prejardhjes* dhe gjermanishtes (zvicerane), siç mund të vërehet shpesh, nuk duhet kategorikisht të pengohen dhe të mënjanohej. Ato i përgjigjen situatave të të rriturit në dhe mes dy gjuhëve dhe mund të përdoren në aspekte të ndryshme (p.sh. si ndihmë në të kuptuarit, për kapërcimin e boshllëqeve, si aktivitet loje) (krahaso fletoren "Rreth përdorimit të dialektit dhe gjuhës standarde" të rreshtit "Materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes", Qendra PNE, Shkolla e lartë pedagogjike e Cyrihut).

### Fushat e kompetencave

#### Vërejtje paraprake për fushat e kompetencave

Fushat vijuese të kompetencave dhe kompetencat janë marrë nga Plani mësimor 21. Natyrisht, formulimet mbështeten në kompetencat e *gjuhës së prejardhjes*.

Përcaktimi i kompetencave specifike dhe përmbajtjeve përkatëse (nënndarja sipas cikleve dhe shkallëve të kompetencave) është detyrë e secilit trup administrativ të HSK-së.

### **Të dëgjuarit**

- Nxënësit mund të nxjerrin informacione të rëndësishme nga materialet dëgjimore.
- Nxënësit mund t'i përcjellin bisedat dhe të tregojnë vëmendjen e tyre.
- Nxënësit mund të nxjerrin informacione nga ajo që është folur.

### **Të folurit**

- Nxënësit mund t'i përdorin si duhet aftësitë motorike në të folur, në artikullim dhe kontrollim të zërit. Ata mund ta aktivizojnë leksikun e tyre produktiv, për t'u shprehur rrjedhshëm dhe në mënyrë të përshtatshme gjithnjë e më shumë edhe në *variantin standard të gjuhës së prejdardhjes* së tyre.
- Nxënësit mund të marrin pjesë aktive në një dialog dhe të ndërmarrin një dialog.
- Nxënësit në situata monologu mund të shprehen përshtatshëm dhe kuptueshëm (për shembull të mbajnë një referat, të recitojnë poezi, ...).
- Nxënësit mund të reflektojnë sjelljen e tyre në të folur, prezantim dhe diskutim.

### **Të lexuarit**

- Nxënësit zotërojnë shkathtësitë bazë të të lexuarit në *gjuhën e prejdardhjes* së tyre.
- Nxënësit mund të nxjerrin informacione të rëndësishme nga tekstet faktike që u përgjigjen moshës dhe parakushteve të tyre
- Nxënësit mund të lexojnë dhe diskutojnë tekste letrare që janë të përshtatshme për moshën dhe parakushtet e tyre dhe të zhvillojnë strategjinë e tyre të të lexuarit.
- Nxënësit mund të reflektojnë sjelljen e tyre në të lexuar dhe në interesimet e tyre për lexim.

### **Të shkruarit**

- Nxënësit mund të shprehen me shkrim në *gjuhën e prejdardhjes* së tyre në një formë e cila i përgjigjet moshës së tyre dhe parakushteve të tyre. Këtu përfshihet një siguri gjithnjë e më e madhe në variantin standard. Ata zotërojnë për shembull një repertor të gjerë të modeleve të fjalive dhe një leksik të mjaftueshëm.
- Nxënësit njohin një gamë të gjerë të modeleve të teksteve dhe mund t'i përdorin në përputhje me objektivin e tyre të të shkruarit në lidhje me strukturën, përmbajtjen, gjuhën dhe formën për prodhimin e tekstit të vet.
- Në bazë të udhëzimeve, instruksioneve dhe modeleve, nxënësit mund t'i ndërtojnë tekstet e tyre në mënyrë kuptimplote dhe të kuptueshme.
- Në përshtatje me parakushtet e tyre dhe moshën e tyre, nxënësit janë të aftë që tekstet e tyre t'i formulojnë në gjuhën standarde që është formalisht sa më korrekte.
- Nxënësit mund të mendojnë për procesin e tyre të të shkruarit dhe produktet e tyre në të shkruar, si dhe të vlerësojnë cilësinë e tyre.



### **Gjuha(ët) në fokus**

- Nxënësit shfaqin mendime, në bazë të pyetjeve dhe detyrave të përshtatshme, për *gjuhën e prejardhjes së tyre* (p.sh. gjinitë gramatikore, formimi i shumësit dhe format kohore, *dialektet*, historia etj.). Këtu ndihmojnë krahasimet me gjermanishten dhe eventualisht me gjuhët tjera që jepen ose fliten në shkollë, për të vënë në pah veçoritë e *gjuhës së prejardhjes* dhe për t'i njohur ato. (*Vetëdija gjuhësore/language awareness*).
- Nxënësit mund të hulumtojnë përdorimin dhe ndikimin e gjuhës.
- Nxënësit zotërojnë përgjatë viteve shkollore njohuri të fituara dhe të ushtruara drejtpërdrejt si dhe gramatikore.

### **Letërsia në fokus**

- Nxënësit njohin tekste letrare të përshtatshme për moshën (rima për fëmijë, tekste këngësh, proza, poezi, tregime gojore etj.) nga *gjuha e prejardhjes së tyre*.
- Nxënësit mund të drejtojnë diskutime për këto tekste dhe të kuptuarit e tyre.
- Nxënësit zotërojnë njohuri për letërsinë e *vendeve të prejardhjes së tyre* (historinë, personalitetet e rëndësishme etj.)
- Nxënësit mund të bëjnë krahasime midis teksteve të lidhura tematikisht nga gjuhët dhe *kulturat e ndryshme*.
- Nxënësit mësojnë, njohin dhe reflektojnë se tekstet letrare në lidhje me përmbajtjen, formën dhe gjuhën janë formuluar në mënyrë të vetëdijshme, për të arritur një ndikim estetik. Ata njohin karakteristikat themelore të zhanreve dhe gjinive letrare.



## 5 Fusha lëndore "Natyra, njeriu, shoqëria"

### Vërejtje paraprake

Fusha lëndore "Natyra, njeriu, shoqëria" (NNJSH) përfshin katër perspektiva "Natyra dhe teknika" (NT), "Ekonomia, puna, ekonomia shtëpiake" (EPESH), "Hapësira, kohët, shoqëritë" (HKSH) dhe "Besimet fetare, kulturat, etika" (RKE). Në ciklin e parë dhe të dytë, katër perspektivat e ndryshme përmbajtjesore janë përfshirë në një fushë lëndore. Prandaj me "Natyra, njeriu, shoqëria" emërtohet e gjithë fusha lëndore nga cikli i parë deri në ciklin e tretë, po ashtu edhe plani mësimor i fushës lëndore në ciklin e parë dhe të dytë. Në ciklin e tretë prezantohen katër perspektivat në fushat specifike lëndore.

### Kuptimi dhe objektivat e fushës lëndore

Nxënësit i zgjerojnë kompetencat e tyre për të jetuar bashkërisht me respekt me njerëzit me prejardhje të ndryshme *kulturore*, për të ndërmjetësuar dhe zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore. Tek këto *kompetenca ndërkulturore* kontribuon krahasimi pa paragjykim dhe reflektues, qoftë mes rajoneve të ndryshme të prejardhjes, *dialekteve*, gjuhëve dhe besimeve fetare, qoftë mes *vendeve të prejardhjes* dhe Zvicrës ose mes *vendeve të prejardhjes* dhe vendeve të tjera. Mësimi nxit një qëndrim të hapur dhe tolerant. Këtu mënjanohe krahasimet stereotipike ose diskriminuese. Për shembull, asnjëherë nuk duhet që një fëmijë të kuptohet si përfaqësues i një besimi fetar, etnie ose gjuhe të caktuar.

Nxënësit merren në mësimin e HSK-së me situatën e tyre si fëmijë dhe të rinj *dy- ose shumëgjuhësh* nga familjet e emigruara *shumëgjuhësore*. Ajo që i lidh në grupin mësimor është *gjuha* e njëjtë e *prejardhjes*. Të ndryshme janë përvojat e tyre personale dhe marrëdhëniet e tyre me *vendet e prejardhjes*. Mësimi merr parasysh dallimet brenda të njëjtit vend të prejardhjes për sa i përket përkatësisë fetare, botëkuptimit, statusit social, gjuhës (variantet dialektore, shumëgjuhësia) dhe gjeografisë lokale.

Mësimi trajton sistemin e vlerave nga Zvicra dhe nga *vendet e prejardhjes*. Duke qenë se nxënësit bëhen të ndërgjegjshëm për ngjashmëritë dhe dallimet, ata i qartësojnë vlerat e tyre personale në lidhje me shumëllojshmërinë. Ky proces nxit zhvillimin e një personaliteti të pavarur, i cili integron sisteme të ndryshme referimi. Njëkohësisht ai forcon vetëbesimin e nxënësve dhe nxënësve.

Mësimi trajton tema faktike dhe thëllon njohuritë mbi *kulturat* e ndryshme. Në bazë të rasteve konkrete mund të krijohen lidhje të tërthorta dhe krahasime.

Mësimi reflekton përvojat që krijohen nga emigrimi dhe imigrimi të cilat i përkasin bashkëjetesës së përditshme në një shoqëri *ndërkulturore*.

Nxënësit njohin historinë dhe gjeografinë e *vendeve të prejardhjes* në fragmente shembullore. Ata krijojnë lidhje me jetën e sotme në *vendet e prejardhjes* dhe në Zvicër.

Në mësimin lëndor, nxënësit mësojnë nocione të reja, të cilat i përvetësojnë si themele njohurish e të cilat njëkohësisht çojnë në zgjerimin e kompetencës së tyre gjuhësore. Nga mësuesi/ja pritet të ketë një vetëdije të lartë gjuhësore, në mënyrë që për secilin mësim, qëllimshëm dhe shprehimisht të vërë në dispozicion mjetet e nevojshme shprehëse dhe fjalorin e nevojshëm lëndor dhe që mund të ushtrohet.

## Fushat e kompetencave

### Vërejtje paraprake për fushat e kompetencave

Kompetencat vijuese janë të orientuara në mënyrë specifike për mësimin e HSK-së dhe janë formuluar në mënyrë përkatëse. Kështu është siguruar, që të mund të adresohen veçoritë e mësimin të HSK-së. Parimet kryesore udhëzuese janë në përputhje edhe me formulimet e kompetencave të Planit mësimor 21. Në listën vijuese, zbatimet specifike në mësimin e HSK-së janë të lidhura me përshkrimet përkatëse të kompetencave të Planit mësimor 21. Megjithatë një sqarim shtesë është i dobishëm me fushat lëndore "Natyra, njeriu, shoqëria" (NNJSH) cikli 1 dhe 2) si dhe për ciklin e 3-të me fushat lëndore "Besimet fetare, kulturat, etika" (RKE) dhe "Hapësira, kohët, shoqëritë" (HKSH) dhe "Ekonomia, puna, ekonomia shtëpiake" (EPESH) si dhe "Natyra dhe teknika" (NT) të Planit mësimor 21. Në mënyrë analoge me fushën lëndore "Gjuhët", nxënësit duhet që kompetencat t'i kenë fituar deri në fund të shkollimit të detyrueshëm.

### Natyra, njeriu, shoqëria - Besimet fetare, kulturat, etika

- Nxënësit mund t'i dëgjojnë të tjerët, t'i perceptojnë ndjenjat dhe të merren me personin që kanë përballë. Ata e rishqyrtojnë vazhdimisht imazhin që e bëjnë për veten dhe për të tjerët.

#### Lidhja me Planin mësimor 21

**NMG.10:** "Komuniteti dhe shoqëria - modelimi i bashkëjetesës dhe të angazhuarit"

**RKE.5:** "Unë dhe komuniteti – modelimi i jetës dhe i bashkëjetesës"

- Ata merren në mënyrë argumentuese me mjediset e ndryshme jetësore në vendet e tyre të prejardhjes dhe të Zvicrës dhe zhvillojnë një mendje të hapur për to. Ata mund të reflektojnë ndjenjat e përkatësisë së tyre për *mjediset e ndryshme jetësore* dhe i integrojnë këto në personalitetin e tyre. Ata gjejnë një mënyrë konstruktive për lojalitetet e ndryshme.
- Nxënësit mund të njohin se në bashkëjetesën njerëzore, konsiderata e ndërsjellë dhe përfillja e rregullave janë thelbësore. Megjithatë, ata janë të vetëdijshëm se këto rregulla bazohen në vlera dhe norma të ndryshueshme dhe që ndryshojnë.
- Ata mund të kuptojnë se përgjigjet për pyetjet themelore varen prej vlerave personale dhe pikëpamjeve për botën. Ata njohin kriteret e vlerave dhe traditat e rëndësishme nga *vendet e prejardhjes* dhe nga Zvicra dhe reflektojnë se nga varen këto vlera personale dhe botëkuptime. Ata njohin kriteret e rëndësishme të vlerave e traditave nga *vendet e prejardhjes* dhe nga Zvicra dhe i reflektojnë ato.
- Ata i emërtojnë ndjenjat personale dhe të huaja dhe i diskutojnë sfidat. Njohuritë bazë të proceseve mendore, emocionale dhe fizike të njerëzve dhe një leksik përkatës në *gjuhën e prejardhjes* i ndihmojnë ata që të kenë një mirëkuptim të thellë për veten dhe për njerëzit e tjerë, si dhe për orientim në jetën personale. Ata zotërojnë nocionet e nevojshme që u mundësojnë atyre të flasin mbi perceptimet personale, nevojat dhe kërkesat.

### **Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.11:** "Zbulimi dhe reflektimi i përvojave bazë, vlerave dhe normave"

**RKE.1:** "Reflektimi i përvojave bazë ekzistenciale"

**RKE.2:** "Sqarimi i vlerave dhe normave dhe marrja e përgjegjësisë për vendimet"

- Nëpërmjet konfrontimit të ndërgjegjshëm me shumë përvoja nga familja, shoqëria, shkolla, *vendet e prejardhjes*, etnia personale dhe institucionet fetare, ata fitojnë njohuri për shumëllojshmërinë e konteksteve dhe veprimeve të ndërsjella. Ata mund të kuptojnë se individit si pjesë e shoqërisë ndikohet nga këto dhe ushtron ndikim mbi to.
- Ata i njohin mirë *vendet e prejardhjes* së tyre. Me pjesëtarët e grupeve të ndryshme të popullsisë në vendet e prejardhjes dhe në Zvicër takohen me sa më pak paragjykime. Ata përpiqen të kuptojnë vlerat dhe format e jetës. Ata mund të njohin paragjykimet e huaja dhe të vetat dhe të merren në mënyrë konstruktive me to.

### **Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.12:** "Njohja me besimet fetare dhe botëkuptimet"

**RKE.3:** "Njohja e gjurmëve dhe ndikimit të besimeve fetare në kulturë dhe në shoqëri"

**RKE.4.4:** "Marrja me besimet fetare dhe botëkuptimet"

### **Natyra, njeriu, shoqëria - Hapësirat, kohët, shoqëritë**

- Përmbajtjet gjeografike, ekonomike dhe ekologjike i zgjerojnë njohuritë për *vendet e prejardhjes*. Njohuritë bazë përkatëse të orientimit i ndihmojnë ata për t'i parë ato në tërësinë e tyre. Ata mund t'i organizojnë dhe peshojnë informacionet nga burimet e ndryshme. Kjo i ndihmon ata edhe që të gjenden si duhet në *vendet e prejardhjes*.
- Nxënësit kuptojnë se nëpërmjet ndjenjave të tyre, mendimeve dhe veprimeve njerëzit ndikojnë në zhvillimet e ndryshme. Ata merren me problemet rajonale, kombëtare dhe globale dhe i perceptojnë ndikimet e tyre drejtpërdrejt në mjedisin e tyre jetësor.

### **Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.7:** "Zbulimi dhe krahasimi i mënyrës së jetesës dhe mjediseve jetësore të njerëzve të ndryshëm "

**RZG.2:** "Mënyrat e jetesës dhe mjediset jetësore të karakterizohen"

**RZG.3:** "Marrëdhëniet njeri - mjedis jetësor të analizohen"

- Nëpërmjet të hulumtimit dhe me ndihmën e fotografive, hartave dhe mediave të tjera (p.sh. faqet e internetit në *gjuhën e prejardhjes*) ata fitojnë një pamje të diferencuar për *vendet e prejardhjes* së tyre falë reflektimit dhe krahasimit me Zvicrën.

### **Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.8:** "Njerëzit përdorin hapësirat – orientimi i vetvetes dhe formimi i së ardhmes"

**RZG.4:** "Të orientohesh në hapësirë"

- Nxënëset dhe nxënësit e njohin dhe e respektojnë pasurinë kulturore të *vendeve të prejardhjes* së tyre nga e tashmja dhe nga e shkuara.
- Duke u bazuar në njohuritë elementare orientuese ata mund t'i klasifikojnë ngjarjet, zhvillimet dhe dëshmitë nga historia dhe e tashmja në *vendet e prejardhjes*. Historia e emigrimit luan këtu një rol të rëndësishëm.
- Ata njohin në bazë të shembujve të zgjedhur, se çdo prezantim është subjektiv dhe përmban vlerësime. Ata e kuptojnë se këndvështrimet dhe interesat e ndryshme mund të kuptohen më mirë nga sfondi i tyre historik



**Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.9:** "Koha, kohëzgjatja dhe ndryshimi të kuptohen - të dallohen historia dhe historitë"

**RZG.6:** "Vazhdimësitë dhe përmbyset e historisë botërore të sqarohen"

**RZG.7:** "Kultura historike të analizohet dhe të përdoret"

– Ata njohin mundësitë për tu angazhuar në shoqëri dhe të ndikojnë dhe jenë edhe vetë bashkëpërgjegjës në zhvillimet e tashme dhe të ardhme.

– Ata njohin të drejtat themelore të njerëzve, përfshirë të drejtat e fëmijëve dhe orientohen sipas tyre. **Lidhja**

**me Planin mësimor 21**

**NMG.10:** "Komuniteti dhe shoqëria - formimi i bashkëjetesës dhe i angazhimit të përbashkët"

**RZG.8:** "Demokracia dhe të drejtat e njeriut të kuptohen dhe të angazhohesh për to"

**Natyrë, njeriu shoqëria -  
Ekonomia, puna, ekonomia  
shtëpiake**

– Nxënëset dhe nxënësit merren me format e jetës- dhe të punës në *vendet e prejardhjes* dhe mund t'i krahasojnë këto me Zvicrën.

– Ata kanë njohuri mbi lidhjet mes politikës, ekonomisë dhe *kulturës*.

**Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.6:** "Puna, prodhimi dhe konsumi - eksplorimi i situatave"

**WAH.1:** "Zbulimi i fushave të prodhimit dhe të punës"

**WAH.3:** "Formimi (modelimi) i konsumit"

**Natyrë, njeriu, shoqëria -  
Natyrë dhe teknika**

– Nxënësit mund të vlerësojnë bashkëveprimet e natyrës, teknikës dhe njeriut në kuadër të ligjeve të vlefshme universale.

– Ata merren me tema ekzemplare mbi natyrën dhe teknikën dhe e zgjerojnë leksikun e *gjuhës* së tyre përkatëse të *prejardhjes*.


**Lidhja me Planin mësimor 21**

**NMG.2:** "Zbulimi dhe ruajtja e kafshëve, bimëve dhe mjediseve jetësore"

**NMG.5:** "Shfrytëzimi, vlerësimi dhe përdorimi i zhvillimeve teknike dhe zbatimeve"

**NT.1:** "Të kuptuarit e esencës dhe rëndësisë së shkencave natyrore dhe e teknikës"

## 6 Për mësimin në secilin nga ciklet



Pasqyrimi 2: Qasjet e orientuara drejt zhvillimit dhe fushat lëndore (krahaso Planin mësimor 21, Kapitulli "Pikat kryesore të ciklit 1." respektivisht . "Pikat kryesore të ciklit 2").

Siç është përshkruar në kapitullin 2.3, Plani mësimor i HSK-së dallohet nga Plani mësimor 21 pasi Plani mësimor kornizë, kompetencat që duhet të fitohen nuk janë ndarë në cikle dhe nivele të kompetencave. Përcaktimi i kompetencave specifike të cikleve dhe të përmbajtjeve përkatëse mbetet në përgjegjësi të trupave përgjegjëse të HSK-së. Përmbajtjet vijuese kuptohen si mendime bazë për secilin nga ciklet.

Tek shumica e kompetencave punohet në të tri ciklet, duke u ndërtuar në formën e një spiraleje mbi njëra-tjetrën. Megjithatë, ndërtimi i disa kompetencave nuk fillon me fillimin e ciklit 1, por në një moment të mëvonshëm kohor, pasi për ndërtimin e tyre duhet të plotësohen parakushte të caktuara në zhvillimin dhe në mësimin e fëmijëve. Ndërtimi i kompetencave të tjera do të përmbyllet në ciklin 3

### Cikli 1

Në ciklin 1 mësimi orientohet fort në zhvillimin e fëmijëve dhe në fillim, para se gjithash, organizohet dhe modelohet në mënyrë mbilëndore. Loja ka rëndësi të madhe. Për të marrë parasysh këtë orientim, Plani mësimor 21 tregon nëntë qasje të orientuara drejt zhvillimit se si mund të lidhet zhvillimi dhe të mësuarit e fëmijës në ciklin 1.

Fëmijët në kopshtin parashkollor mësojnë nëpërmjet përvojave ndijore dhe veprimeve, në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet imitimit. Ata i mësojnë gjërat në ndërlidhje. Atë që e mësojnë shkarazi ose pa dashje, e shprehin me fjalë me përkrahjen e mësuesit dhe e shndërrojnë në njohuri të qarta. Për shembull, ata hidhen nga një shkallë dhe këtu mësojnë shprehjen shkallë, por edhe teknikën e hedhjes dhe ndjenjën e frikës ose të suksesit. Prandaj mësimi zhvillohet nga përvojat e përditshmërisë së fëmijëve dhe krijojnë situata për veprime personale dhe përvoja.

Mësimi ofron përjetime nëpërmjet të cilave fëmijët mësojnë që fotografitë (pamjet) dhe idetë t'i përmbledhin në fjalë dhe fjali. Përkrahja në leksik merr parasysh, përpos *mjedisit jetësor* të fëmijëve, edhe fjalë funksionale për orientim në hapësirë (ku, mbrapa, mbi etj.) dhe tek marrëdhëniet logjike (më shumë, më pak, e njëjta sasi etj.).

Mësimi nëpërmjet të mënyrës së lojës i bën fëmijët që të njihen mirë me botën e librave me figura dhe të teksteve. Fëmijët mësojnë se simbolet, shenjat dhe piktogramet nga përditshmëria e tyre kanë një kuptim.

Fëmijët njohin atë që shkruhet dhe funksionet e shkrimit. Ata mësojnë të merren me materialet në mënyrë të qëllimshme dhe kontrolluese. Në varësi të parakushteve të tyre individuale, ata fillojnë të lexojnë dhe të shkruajnë.

Për fëmijët e klasës së parë dhe të dytë, përvojat e përditshme personale në familje në *vendet e prejardhjes* dhe në Zvicër janë pikënisje. Lidhja me familjen dhe orientimi drejt vlerave të tyre janë ende të forta në këtë moshë.

Në mësim përkrahen të gjitha fushat gjuhësore: të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, gjuha(ët) në fokus, letërsia në fokus. Këtu gjejnë zbatim para se gjithash format mësimore përmes lojës, por pjesërisht edhe trajnimi sistematik dhe me qëllime të vendosura. Hyrja në të lexuar dhe në të shkruar përfshin alfabetizimin në gjermanisht. Rekomandohet shumë një qasje e koordinuar mes mësuesit të HSK-së dhe mësuesit të klasës së rregullt. Nëse është e arsyeshme, mësuesi i HSK-së bën krahasime me alfabetin gjerman, për të mënjeluar keqkuptimet.

## Cikli 2

Për fëmijët e ciklit të dytë, grupi i bashkëmoshatarëve është shumë i rëndësishëm. Ata zhvillojnë një interes të natyrshëm për mënyrat e ndryshme të jetesës dhe mjediset e jetesës me të cilat janë në kontakt. Me mjedisin e tyre (familja, shkolla) ata kanë një marrëdhënie pozitive dhe nuk e vënë atë gati fare në dyshim. Si rregull ata janë të paanshëm, të hapur, spontanë në raport me *kulturën* e tyre dhe të të tjerëve dhe janë të interesuar për marrëdhëniet dhe lidhjet me familjen e tyre në *vendet e prejardhjes*.

Në mësim përkrahen të gjitha fushat gjuhësore, të dëgjuarit dhe të shprehurit, të lexuarit dhe të shkruarit, gjuha(ët) në fokus dhe letërsia në fokus. Një vëmendje e veçantë i kushtohet zgjerimit të kompetencave në regjistrat gjuhësorë kërkues, kompleksë.

## Cikli 3

Në ciklin 3 të rinjtë merren në mënyrë kritike me vlerat e tyre dhe ato të mjedisit. Si rezultat, ata largohen sipas rrethanave nga vlerat dhe normat tradicionale ose i idealizojnë ato. Shpesh ata vënë në dyshim të kuptuarit e mësimin të HSK-së.

Mësuesi i HSK-së e kupton këtë situatë përmbysjeje, i përgjigjet asaj dhe në mënyrë kritike sjell modele (jetësore) të ndryshme në mësim. Në këtë mënyrë, ai i ndihmon të rinjtë që të orientohen, ta zhvillojnë personalitetin e tyre dhe të gjejnë një rrugë të tyre. Veçanërisht i përkrah të rinjtë që t'i integrojnë në jetën e tyre përvojat, vlerat dhe përkatësitë e ndryshme.

Mësimi merr parasysh aftësitë dhe njohuritë individuale të të rinjve. Nxënësit inkurajohen të kontribuojnë me njohuritë e tyre specifike *kulturore* dhe *ndërkulturore*, jo vetëm në mësimin e HSK-së, por edhe në mësim në shkollën fillore dhe jashtë shkollës.

Një vend të rëndësishëm në mësim kanë komunikimi me gojë dhe me shkrim, vështrimet gjuhësore dhe edukimi mediatik. Të rinjtë kanë mundësinë që kompetencat e fituara në gjuhë të ndryshme (*gjuhën e prejardhjes*, gjermanisht, frëngjisht, anglisht) t'i përdorin, të nxjerrin analogjitë dhe t'i lidhin njohuritë e tyre. Kështu ata mund të zgjerojnë kompetencën e tyre gjuhësore dhe vepruese.



Mësimi i përkrah të rinjtë që të zhvillojnë një perspektivë të profesionit dhe të integrohen në fushën e punës dhe në shoqërinë zvicerane. Mësimi i forcon ata veçanërisht që t'i perceptojnë dhe t'i përdorin kompetencat dy- ose shumëgjuhësore dhe ndërkulturore si pasuri plotësuese.

# 7 Fjalorth

**Shpjegimet e mëposhtme përshkruajnë se si kuptohen nocionet përkatëse në këtë tekst.** Aty ku nuk është shënuar ndryshe, shpjegimet e mëposhtme bazohen në *Planin mësimor kornizë për Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut* e Drejtorisë arsimore të kantonit të Cyrihut si dhe në publikimin *Mësimi në Gjuhën e Atdheut*, të botuar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Konferencës së Drejtorëve të Edukimit (KDE).

## Dygyjuhësia

→ Shih *Gjuha e dytë*.

## Dialekti

Dialekti ose e folmja dialektore është një variant lokal ose rajonal i një gjuhe standarde (p.sh. gjermanisht) ose një gjuhe rajonale (p.sh. gjermanishtja zvicerane).

Ai mund të ndryshojë fort ose pak nga *varianti standard* i *gjuhës së prejardhjes* dhe pjesërisht funksionon si *gjuhë lokale*.

## Gjuha e parë (L1), Gjuha e prejardhjes

Si gjuhë e parë emërtohet gjuha e parë e socializimit, pra gjuha që në aspektin kronologjik, një person e ka mësuar të parën. Në përditshmëri e quajmë "*Gjuha amtare*". Shumë fëmijë mësojnë së pari jo vetëm një, por dy ose më shumë gjuhë. Në raste të tilla, pra kur një person ka disa gjuhë të para, flitet për dygyjuhësinë e njëkohshme. Gjuha e parë mund të mbetet në vazhden e jetës gjuha dominuese, por ajo mund ta humbë pjesërisht rëndësinë, veçanërisht nëse nuk korrespondon me gjuhën e mësimin ose *gjuhën lokale* të vendbanimit të një personi.

Gjuha e prejardhjes së një personi është ajo gjuhë ose ai dialekt, e cila apo i cili në *vendet e prejardhjes* ose në rajonet e prejardhjes konsiderohet si *variant standard* ose lokal. Nëse një person i përket gjeneratës së dytë apo të tretë të emigrimit, atëherë gjuha e prejardhjes së tij nuk duhet të jetë gjithsesi gjuha e parë.

## Gjuha e specialitetit

Gjuha e specialitetit është një variant i *variantit standard* të *gjuhës së prejardhjes*, e cila karakterizohet nga një leksik specifik i specialitetit.

## Gjuha e huaj

Një gjuhë e huaj është një gjuhë e cila mësohet përveç gjuhës së parë dhe jashtë vendit ku konsiderohet si *gjuhë lokale*. Me këtë, gjuha e huaj dallohet nga gjuha e dytë, e cila mësohet në vendin e gjuhës së synuar. Mësimi i gjuhëve të huaja të caktuara është detyrë e shkollës publike. Në shkollat publike të kantoneve zvicerane mësohen zakonisht gjuhët zyrtare të pjesëve të tjera të vendit si dhe anglishtja si gjuhë e huaj.

### **Shumëgjuhësia funksionale**

Shumëgjuhësia funksionale është aftësia e një personi për të komunikuar në disa gjuhë që i përshtaten situatave dhe nevojave. Kjo lloj kompetence gjuhësore është në kundërshtim me *shumëgjuhësinë* e ekuilibruar dhe simetrike. Nëpërmjet vlerësimit të *shumëgjuhësisë* funksionale pranohet se ka aftësi themelore të ndryshme të zhvilluara mirë të kompetencës gjuhësore. Kështu që nuk është gjithmonë e nevojshme që në secilën aftësi bazë të arrihet shkalla më e lartë, nganjëherë mjafton për t'i përmbushur qëllimet e veta, duke zotëruar vetëm shkathtësitë e caktuara dhe që ato mund të përdoren në mënyrë funksionale. Arsimitimi i *shumëgjuhësisë* funksionale është një nga objektivat e shkollës publike.

### **Vendet e prejardhjes, shtetet e prejardhjes**

Me vendet e prejardhjes nënkuptohen ato shtete, në të cilat një person ose një kujdestar ligjor (apo të afërm të tjerë) kanë jetuar më parë ose jetojnë ende. Njerëzit mund të kenë një lidhje të fortë të ndryshme me vendet e prejardhjes, e cila mund të varet, për shembull, nga gjenerata e migracionit.

### **Gjuha letrare**

→ Shih *varianti standard* i *gjuhës së prejardhjes*

### **Identiteti, identiteti dy-/ shumëkulturor**

Si identitet (individual) kuptohet veçantia e një njeriu dhe ndjeshmëria për vetveten. Identitetet janë procesuale dhe dinamike. Ato krijohen në ndërveprimet sociale, veçanërisht nëpërmjet gjuhës. Me një identitet dy-/shumëkulturor kuptohet ndjenja e përkatësisë subjektive, për t'iu përkitur në të njëjtën kohë dy (ose më shumë) kolektiveve të ndryshme dhe për t'u identifikuar me një pjesë të atyre vlerave dhe qëndrimeve.

### **Integrimi**

Integrimi këtu kuptohet si proces, në të cilin personat dhe grupet me sfond të ndryshëm social, *kulturor* dhe gjuhësor, arrijnë pjesëmarrje të barabartë sociale dhe politike në një shoqëri dhe respektohen me sfondin e tyre të veçantë gjuhësor dhe *kulturor*.

### **Kompetenca**

Përkufizimi "kompetenca" në kapitullin "Bazat" të Planit mësimor 21 bazohet në parashtrimet e Franz E. Weinert. Sipas tij kompetencat përfshijnë "disa aspekte përmbajtësore dhe të lidhura me proceset: aftësitë, shkathtësitë dhe njohuritë, por edhe gatishmëritë, qëndrimet dhe pikëpamjet. [...] Aspektet e kompetencave janë të natyrës së specialitetit dhe asaj mbilëndore. Kompetencat e specialitetit përshkruajnë njohuritë specifike të specialitetit dhe aftësitë e shkathtësitë të lidhura me to. Me kompetencat mbilëndore nënkuptohen ato njohuri dhe aftësi që kalojnë nëpër fushat e specialitetit e më tutje dhe luajnë një rol të rëndësishëm për të mësuarit në shkollë dhe jashtë saj. Këtu përfshihen kompetencat personale, sociale dhe metodike."

## **Kultura**

Kultura shikohet në këtë Plan mësimor kornizë si tërësi e aspekteve të papërsëritshme mendore, materiale dhe emocionale, që e karakterizojnë një shoqëri ose një grup etnik. Kjo nuk përfshin vetëm artin dhe letërsinë, por edhe format jetësore, të drejtat themelore të njerëzve, sistemet e vlerave, traditat dhe besimet. Individët nuk mund të reduktohen në kulturën e tyre apo në grupin e tyre etnik. Ata pra nuk duhet të kenë patjetër tipare të caktuara, vlera ose mënyra të sjelljes, vetëm pse i takojnë një kulture të caktuar. Veç kësaj kultura e një shoqërie ose e një grupi etnik nuk është as homogjene, as statike dhe as e mbyllur. Përkundrazi, praktika kulturore krijon vazhdimisht kuptime të reja dhe praktikat e ndryshme kulturore përzihen.

## **Mjedisi jetësor**

Plani mësimor kornizë nënkupton me shprehjen mjedis jetësor tërësinë e të gjitha gjërave, ngjarjeve dhe rrethanave, me të cilat njerëzit merren në të tashmen e tyre. Një mjedis jetësor është vetëm një pjesë e botës së tërësishme, në varësi të situatave jetësore individuale. Plani mësimor kornizë nuk bën dallim të prerë mes *kulturës* dhe mjedisit jetësor, por thekson tek nocioni i dytë më shumë raportet e individit me të tashmen e tij si dhe të vepruarit personal dhe të shprehurit.

## **Gjuha lokale**

Gjuha lokale është gjuha në të cilën komunikon shumica e popullsisë së një vendi. Në rastin e Zvicrës gjuhët lokale janë ose *dialektet* e gjermanishtes zvicerane ose gjuhët frëngjisht, italisht ose retoromanisht.

## **Shumëgjuhësia, shumëgjuhësh**

Nocioni shumëgjuhësi emërton fenomenin ku kompetencat gjuhësore janë të pranishme në tri ose më shumë gjuhë. Nocioni mund të emërtojë si një person të veçantë e po ashtu edhe shoqëri të tëra. Me këtë në Zvicër përkufizohet nganjëherë edhe fenomeni që fliten katër gjuhë zyrtare. Në këtë Plan mësimor kornizë flitet atëherë për një individ shumëgjuhësh, nëse ky zotëron kompetenca aktive ose pasive në tri apo më shumë gjuhë, pavarësisht marrëdhënies individuale me këto gjuhë (*gjuha e parë, gjuha e dytë, gjuha e prejardhjes, gjuha e huaj*). Në këtë kuptim, për shembull, një fëmijë është edhe shumëgjuhësh edhe nëse e flet gjermanishten si *gjuhë të parë* dhe në mënyrë plotësuese edhe dy *gjuhë të huaja*.

→ Shih edhe *Dy- ose shumëgjuhësia*.

## **Gjuha amtare**

Me gjuhë amtare është menduar gjuha e parë që zotërohet, pra *gjuha e parë*. Nocioni është i pasaktë sepse nisët nga fakti që vetëm nëna është vendimtare për zotërimin e gjuhës së parë. Andaj, Plani mësimor kornizë flet vetëm për *gjuhën e parë*.

## **Vetëdija gjuhësore (Language Awareness)**

Vetëdija gjuhësore (ose Language Awareness) ka të bëjë me njohuritë e qarta mbi gjuhën, perceptimin e vetëdijshëm të gjuhës si dhe sensibilizimin e përdorimit të gjuhës dhe proceseve të mësimin të gjuhës. Këtu përfshihet komunikimi metagjuhësor, p.sh. ndarja apo përzierja e gjuhëve, si dhe krahasimet gjuhësore, p.sh. mes *gjuhës së parë dhe të dytë* ose mes gjuhës standarde dhe dialektit.



. Objektivat pedagogjike të vetëdijes gjuhësore janë ndër të tjera kureshtja dhe interesimi për gjuhën(ët), respektimi dhe njohja e shumëllojshmërisë gjuhësore (në klasë, në shoqëri) si dhe një pamje shumëperspektivëshe mbi gjuhën dhe ndërveprimin.

### **Varianti standard i gjuhës së prejardhjes**

Versioni i normuar i një gjuhe që shpallet i kodifikuar dhe i detyrueshëm në fjalorë dhe gramatika është varianti standard i *gjuhës së prejardhjes*. Kjo quhet nganjëherë edhe gjuha e shkruar, letrare ose e nivelit të lartë dhe përgjithësisht dallohet nga *dialektet*. Nëse varianti standard është gjithnjë në situata të caktuara në përdorim, por në përditshmëri flitet një *dialekt*, atëherë flasim për diglosinë. Zotërimi i variantit standard konsiderohet si qëllim kryesor i përpjekjeve didaktiko-gjuhësore i shkollës publike dhe i mësimin të HSK-së.

### **Kompetenca ndërkulturore, të mësuarit ndërkulturor**

Kompetencë ndërkulturore emërtohet aftësia për të vepruar me sukses me njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore. Ajo mund të zhvillohet nëpërmjet të mësuarit ndërkulturor ose përkrahet nëpërmjet të përvojave në *mjedise jetësore* të ndryshme.

### **Gjuha e dytë (L2)**

Gjuha e dytë është ajo gjuhë e cila në kuptimin kronologjik mësohet si e dyta. Tek personat me prejardhje migrimi ajo është shpesh gjuha, e cila ua mundëson atyre pjesëmarrjen në jetën shoqërore dhe në kulturën e të shkruarit në shoqërinë gjuhësore lokale, p.sh. gjermanisht në Zvicrën gjermanishtfolëse. Pra gjuha e dytë ndryshon nga *gjuhët e huaja*, pasi është kryesisht ose shpesh e nevojshme për përballimin e përditshmërisë. Nëse personat i përkasin gjeneratës së dytë ose të tretë të emigracionit, atëherë mund të jetë edhe *gjuha vendase* si *gjuhë e parë* dhe *gjuha e prejardhjes* si gjuhë e dytë, gjegjësisht L2 mund të bëhet gjuha dominuese gjatë kohës së shkollimit.

### **Përvetësimi i gjuhës së dytë**

Në didaktikën gjuhësore bëhet dallimi mes përvetësimit të gjuhës së dytë dhe *gjuhës së huaj*. Nëse një person përshtatet me gjuhën e dytë në rajonin ku kjo gjuhë flitet si *gjuhë lokale*, atëherë bëhet fjalë për të përvetësuarit e një gjuhe të dytë. Mësimi i gjuhës përkatëse trajtohet në një didaktikë gjuhësore të veten, e cili dallohet nga didaktikat për përvetësimin e *gjuhës së parë* dhe të gjuhës së huaj.

### **Dy- ose shumëgjuhësia, dy- ose shumëgjuhësh**

Në kuptim më të gjerë dy- ose shumëgjuhësh është dikush që ka kompetenca aktive ose pasive në dy ose më shumë gjuhë. Megjithatë, në këtë Plan mësimor kornizë përdoret një përkufizim më i ngushtë: Këtu emërtohen si dy- ose shumëgjuhësh vetëm personat, nëse ata flasin gjermanisht dhe një ose më shumë *gjuhë të prejardhjes* jogjermane.



## 8 Shtojcat

# Shtojca I: Kushtet e përgjithshme në kantonin e Cyrihut

**Kjo shtojcë jep fillimisht një pasqyrë mbi bazat ndërkantonale dhe ligjore të mësimit të HSK-së. Së fundi, Zyra e arsimit fillor të Cyrihut përshkruan praktikën (procedurën, organizimin, bashkëpunimin) që është zhvilluar në kanton, në bazë të kushteve të përgjithshme ligjore.**

### Bazat ndërkantonale

Konferenca e Drejtorëve Kantonalë (KDE) ka shprehur disa herë qëndrimet për mësimin e HSK-së. Në "Rekomandimet për shkollimin e fëmijëve me gjuhë të huaj" të 24 tetorit 1991 ajo e fuqizon të drejtën bazë të fëmijëve me *sfond migrimi*, "të përkujdesen për gjuhën dhe kulturën e vendit të prejardhjes". Në veçanti, KDE u rekomandon autoriteteve përgjegjëse kantonale ose lokale:

- mësimin e HSK-së ta përkrahin në formë të përshtatshme dhe sipas mundësive t'i integrojnë së paku dy orë mësimore javore në kohën mësimore,
- t'i vënë në shfrytëzim lokalet e nevojshme shkollore pa pagesë,
- ta përkrahin bashkëpunimin mes mësuesve të klasave të rregullta dhe të atyre të HSK-së,
- ta dokumentojnë vijimin e mësimit të HSK-së si dhe notimin në dëftesën shkollore,
- t'i informojnë prindërit me sfond migrimi për sa u përket ofertave arsimore,
- tek vlerësimi i nxënësve si dhe tek promovimi dhe vendimet për përzgjedhje, t'i marrin parasysh kompetencat në gjuhën e prejardhjes, të cilat janë fituar në mësimin e HSK-së.

KDE-ja parashikon edhe në Strategjinë kombëtare për mësimin e gjuhëve të 2004 që të përkrahen *gjuhët e prejardhjes* së fëmijëve me sfond migrimi (krahaso "Mësimi i gjuhës gjatë shkollës së detyrueshme: Strategjia e KDE-së dhe plani i punës për koordinimin mbarëkombëtar e 25 marsit 2004). Të njëjtin qëllim e ndjek edhe marrëveshja ndërkantonale mbi harmonizimin e shkollës së detyrueshme, pasi kantonet e konkordatit detyrohen që t'i përkrahin kurset e HSK-së që janë neutrale në aspektin fetar dhe politik (krahaso Marrëveshjen ndërkantonale mbi harmonizimin e shkollës së detyrueshme (HarmoS) të 14 qershorit 2007.). Federata që nga viti 2011 përkrah, në kuadër të ligjit për gjuhët, projekte për mësimin e HSK-së (krahaso Ligjin federal mbi gjuhët e vendit dhe mirëkuptimin mes bashkësive gjuhësore (Ligji për gjuhët, Lpgj) i 5 tetorit 2007 si dhe Urdhëresa mbi gjuhët e vendit dhe mirëkuptimin mes bashkësive gjuhësore (Urdhëresa për gjuhët, Upgj) e 4 qershorit 2010).

### Bazat ligjore në kantonin e Cyrihut

Në kantonin e Cyrihut, mësimi i HSK-së është i rregulluar në aspektin ligjor përmes Ligjit të shkollës fillore dhe të Urdhëresës së shkollës fillore:

#### Ligji i shkollës fillore i 7 shkurtit 2005

##### § 15.

- 1 Drejtoria mund t'i njohë kurset e ofruara të Gjuhës dhe Kulturës së Atdheut nga organet përgjegjëse jashtëshkollore.
- 2 Urdhëresa rregullon parakushtet e njohjes dhe pasojat e saj.

#### Urdhëresa e Shkollës fillore e 28 qershorit 2006



### § 13.

- 1 Në kurset e Gjuhës dhe Kulturës së Atdheut, nxënësit me gjuhë të huaj i zgjerojnë njohuritë në gjuhën e tyre të parë dhe mbi kulturën e vendit të tyre të prejardhjes.
- 2 Ofrues të kurseve janë ambasadat ose konsullatat e vendeve të prejardhjes. Drejtoria arsimore mund t'i njohë edhe kurset e organeve të tjera përgjegjëse.
- 3 Kurset njihen nëse i përgjigjen Planit mësimor kornizë të nxjerrë nga Këshilli arsimor, janë asnjans në aspektin politik dhe fetar dhe nuk janë të orientuara drejt fitimit. Kurset përfshijnë më së shumti katër orë mësimi në javë, kurse në nivelin parashkollor dhe në klasën e parë të nivelit primar më së shumti dy orë mësimi në javë.
- 4 Mësimdhënësit duhet të kenë një diplomë si mësues/-e dhe të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane si dhe t'i ndjekin seminarët e detyrueshme.

### § 14

- 1 Kurset vendosen mundësisht jashtë orarit të rregullt mësimor.
- 2 Komunat
  - a. vënë në shfrytëzim mundësisht hapësira të përshtatshme dhe pa pagesë,
  - b. i lirojnë nxënësit më së shumti për dy orë në javë nga mësimi i rregullt, nëse kurset zhvillohen gjatë kohës së mësimit të rregullt.
  - c. Lajmërojnë Drejtorinë arsimore në rast të problemeve gjatë kryerjes së kurseve.
- 3 Notat e kursit shënohen në dëftesë.
- 4 Drejtoria arsimore rregullon procesin e regjistrimit. Veç kësaj, organizimi dhe zhvillimi i kurseve është çështje e organeve përgjegjëse, sidomos financimi si dhe zgjedhja, punësimi dhe mbikëqyrja e mësimdhënësve.

#### Organizimi dhe udhëheqja e mësimit në kantonin e Cyrihut

Më poshtë përshkruhet praktika e HSK-së në kantonin e Cyrihut, e cila është zhvilluar në kanton në bazë të kushteve ligjore. Temat e këtij nënkapitulli janë renditur alfabetikisht.

#### Njohja e organeve përgjegjëse

Drejtoria arsimore mund t'i njohë kurset e HSK-së nga organet përgjegjëse jashtëshkollore, nëse plotësohen kërkesat ligjore dhe parimet e brendshme. Zyra e arsimit fillor rregullon dhe kryen procedurën e njohjes. Nëse kurset e njohura të HSK-së janë të disponueshme vetëm në gjuhën përkatëse, atëherë organi përgjegjës ekzistues kontaktohet dhe kërkohet një bashkëpunim. Objektivi është një ofertë uniforme e HSK-së e mbështetur gjerësisht për secilën gjuhë.

Në mënyrë që kurset e HSK-së të një organi përgjegjës të njihen, ai duhet që veçanërisht

- të sigurojë që kurset t'i përgjigjen Planit mësimor kornizë të HSK-së dhe të jenë asnjans në aspektin konfesional dhe politik,
- të ketë mësues/e të kualifikuar/a me njohuri përkatëse të gjermanishtes,
- të mos jenë fitimprurëse,
- të bashkëpunojnë me shkollat vendore dhe Drejtorinë arsimore.

#### Certifikata dhe bartja e notës në dëftesë

Shih kapitullin 3, faqe 9

### **Mbikëqyrja**

Mësimi i HSK-së i nënshtrohet mbikëqyrjes së organeve përgjegjëse në aspektin pedagogjik dhe të personelit. Për sa i përket pikave të rregulluara në rregulloren e shkollës fillore, ky mësim i nënshtrohet mbikëqyrjes së organeve të shkollës.

Është çështje e organeve përgjegjëse që të kontrollojnë pjesëmarrjen dhe ndoshta marrjen e masave për vonesat e pjesëmarrësve të kursit. Ata u mundësojnë organeve shkollore, nëse e kërkojnë, një vështrim në kontrollimin e pjesëmarrjes dhe në mësim. Të drejtën e kontrollit e kanë edhe mësuesit e shkollës fillore, që i lirojnë nxënësit nga mësimi i tyre me qëllim të vijimit të HSK-së.

Nëse ndonjë problem nuk mund të zgjidhet drejtpërdrejt me mësimdhënësit, atëherë bëhet një bisedë mes bordit përkatës shkollor dhe organeve përgjegjëse. Nëse problemet serioze nuk përmirësohen, pavarësisht nga vërejtja, atëherë Drejtoria arsimore, me kërkesë të bordit të shkollës, mund t'ia heqë të drejtën organit përgjegjës përkatës për të zhvilluar mësimin për të cilin është bërë ankesa, në kuadër të Shkollës fillore.

### **Financimi**

Financimi i HSK-së është çështje e organeve përgjegjëse. Disa komuna shkollore ndihmojnë me kontribute financiare ose punësojnë vetë ndonjë mësues/e të HSK-së. Te shumica e organeve përgjegjëse prindërit japin një kontribut.

### **Mësuesit e HSK-së**

Zgjedhja dhe punësimi i mësuesve është çështje e organeve përgjegjëse.

Organet përgjegjëse kujdesen që mësuesit që janë të rinj në mësimdhënie në kanton,

- të jenë të kualifikuar në mënyrë të mjaftueshme në aspektin pedagogjik (diploma e mësuesisë ose arsimim i barasvlershëm ose përvojë përkatëse dhe arsimim të mëtjshëm),
- të kenë njohuri të mjaftueshme të gjuhës gjermane për komunikim gojor (mësuesit e dokumentojnë këtë me një certifikatë se e kanë arritur nivelin B1 të Kornizës Referuese Evropiane),
- vijojnë takimin informativ, i cili zhvillohet nga Drejtoria arsimore (Zyra e arsimit fillor),
- vijojnë modulin hyrës, i cili ofrohet nga shkolla e lartë pedagogjike e Cyrihut, me porosi të Drejtorisë arsimore.

Nëse një mësues i HSK-së nuk i plotëson kërkesat e mësipërme, Drejtoria arsimore kërkon nga organi përgjegjës i kursit që të merren masat korigjuuese. Drejtoria arsimore mund t'ia marrë lejen mësuesit përkatës për të dhënë mësim në kurset e njohura kantonale të HSK-së.

Për veprimtarinë mësimore të mësuesve të HSK-së është me përparësi, nëse familjarizohen me rrethanat shkollore të këtushme. Për këtë arsye u propozohet organeve përgjegjëse që mësuesit të mos ndërrohen pas pak viteve (të mos ketë "parim rotacioni").

### **Informacioni dhe regjistrimi**

Secili nga trupat administrative e po ashtu edhe shkollat lokale dhe Zyra e arsimit fillor i informojnë fëmijët përkatës dhe prindërit e tyre mbi ofertat ekzistuese mësimore. Mësimi mund të vijohet prej kopshtit parashkollor ose prej një momenti kohor të mëvonshëm, sipas ofertës së gjuhës përkatëse.

Mësuesit e shkollës fillore u shpërndajnë prindërve një formular regjistrimi në janar.

Prindërit e regjistrojnë drejtpërdrejt fëmijën e tyre tek personi që koordinon kurset e HSK-së së organit përgjegjës përkatës. Organet përgjegjëse i informojnë paraprakisht dhe drejtpërdrejt prindërit për mësimin konkret (oraret, vendet, mësuesin e HSK-së) ose për mosrealizimin e tij të mundshme. Mësimi fillon parimisht me fillimin e vitit shkollor. Regjistrimi i detyron për vijimin e rregullt të mësimit dhe vlen deri tek një çregjistrim nga ana e prindërve gjegjësisht deri në përfundim të shkollimit të detyrueshëm.

### **Mjetet dhe materialet mësimore**

Furnizimi me mjete mësimore është çështje e organeve përgjegjëse.

Komunave shkollore u rekomandohet që mësuesve të HSK-së t'u jepen në shfrytëzim pa pagesë mjetet teknike mësimore (aparati fotokopjues dhe nëse ka, aparat/vizualizues, kompjuter, qasje në internet e të tjera) si dhe materiale mësimore (shkumësa, fletore, letër dhe të ngjashme).

### **Kohët dhe hapësirat mësimore**

Nxënësit e vijnë në mësimin e HSK-së në nivelin e kopshtit parashkollor dhe në klasën e parë të nivelit primar më së shumti për dy orë mësimore në javë, në klasat vijuese deri më së shumti katër orë në javë. Nëse është e mundur, mësimi i HSK-së zhvillohet gjatë orarit të rregullt mësimor (nga ora 8 deri në orën 12, dhe nga ora 13:30 deri në orën 17:00). Mund të zhvillohet maksimumi për dy orë edhe në vend të mësimit të rregullt. Në këtë rast, fëmijët në fjalë, lirohen nga mësimi përkatës.

Organet përgjegjëse i pyesin përgjegjësit e shkollave lokale në fillim të çdo viti për dhomat e mësimit dhe caktojnë oraret e dëshiruara mësimore. Kohët përfundimtare vendosen pas marrëveshjes mes organeve përgjegjëse dhe përgjegjësve lokalë.

Mësimi i HSK-së zhvillohet parimisht në hapësirat e shkollës fillore publike, mundësisht në afërsi të vendbanimit të fëmijëve. Komunitat shkollore vënë në shfrytëzim, sipas mundësive, hapësira të përshtatshme shkollore pa pagesë. Mësuesit e HSK-së kujdesen për respektimin e rregullit shtëpiak.

Organet përgjegjëse i informojnë përgjegjësit lokalë të shkollës përkatëse në fillim të vitit shkollor mbi organizimin definitiv të mësimit (klasat, oraret, dhomat e mësimit, mësuesit e HSK-së). Organet përgjegjëse ua dërgojnë këto informacione edhe Drejtorisë arsimore, së cilës këto të dhëna i shërbejnë për t'u informuar mbi mësimin e HSK-së dhe për të përkrahur koordinimin e tyre.

### **Bashkëpunimi mes mësuesve të HSK-së dhe shkollës lokale**

Mësuesve të shkollës fillore dhe atyre të mësimit të HSK-së u rekomandohet që të kërkojnë kontakt të dyanshëm. Një mënyrë e arsyeshme është që drejtoritë e shkollave t'i ftojnë mësuesit e HSK-së në konferencat shkollore për të trajtuar temat me interes të dyanshëm. Ata mund t'i ftojnë mësuesit e HSK-së edhe herë pas here, për shembull një herë në vit, në një takim për shkëmbim mendimesh. Qëllimi i një takimi të tillë mund të jetë njohja me njëri-tjetrin, shkëmbimi i njohurive dhe përvojave ose për t'i biseduar shqetësimet e përbashkëta.

Mësimi i HSK-së është një shërbim në kuadër të shkollës fillore. Është e arsyeshme që mësuesit e HSK-së të marrin pjesë në aktivitetet e shkollës dhe në proceset e zhvillimit të shkollave. Veçanërisht shkollat me një përqindje të lartë të fëmijëve shumëgjuhësh përfitojnë nga bashkëpunimi i institucionalizuar. Kjo do të thotë përkrahje e përbashkët për secilin nga fëmijët, realizim i projekteve mësimore shumëgjuhëshe dhe ndërkulturore ose për t'i informuar dhe këshilluar prindërit bashkërisht. Jo vetëm mësuesit e klasave të rregullta, por edhe mësuesit lëndorë të shkollës fillore, si për shembull, mësuesit e gjermanishtes si gjuhë e dytë (GjsGJD) mund të përfitojnë nga ky bashkëpunim. Mësuesit e HSK-së të cilët janë të kualifikuar përkatësisht,

punojnë me sukses në përkthimin dhe ndërmjetësimin *ndërkulturor*. Është shumë e arsyeshme që mësuesit e HSK-së të marrin pjesë tek vlerësimet që kanë të bëjnë me nxënësit, të cilëve u japin mësim: tek vlerësimet në të mësuar, tek bisedat përcaktuese shkollore, tek vendimet mbi shkollimin e mëtejshëm.

Zyra e arsimit fillor i rekomandon shkollat me përqindje të lartë të fëmijëve dy- ose shumëgjuhësh, që mësimin e HSK-së ta shohin si pjesë të përkrahjes gjuhësore dhe ta integrojnë në programin e shkollës lokale.

### **Përkrahja e bashkëpunimit shkollë - prindër**

Bashkëpunimi mes shkollës dhe shtëpisë prindërore ka parimisht një ndikim të madh në të mësuar dhe në suksesin shkollor të fëmijëve dhe të rinjve. Ka ndikim pozitiv në suksesin mësimor, nëse mësuesit e HSK-së janë në kontakt të vazhdueshëm me prindërit, i informojnë ata mbi ndodhitë në shkollë dhe bisedojnë me ta se si mund t'i përkrahin fëmijët e tyre në të mësuar.

Mësuesit e HSK-së mund t'i përkrahin mësuesit e shkollës fillore në bashkëpunimin me prindërit. Për shembull, ata punojnë në mbledhjet me prindër ose përkthejnë në bisedat e veçanta. Gjithashtu ata mund të angazhohen në ndërmjetësimet ndërkulturore por që kjo kërkon njohuri të mira në të dy gjuhët dhe sistemet shkollore. Shërbime të tilla ata ofrojnë pas marrëveshjes me mësuesit dhe me përgjegjësit e shkollave.

### **Bashkëpunimi me autoritetet shkollore**

Autoritetet shkollore lokale kontribuojnë që mësimi i HSK-së të mund të zhvillohet në kushte të mira në kuadër të shkollës fillore. Atyre u rekomandohet që sipas nevojës të caktojnë një person në komunë ose në njësinë shkollore për koordinim. Këtij i mbetet përgjegjësia për të bërë marrëveshje me kohë sa i përket hartimit të orarit mësimor dhe nevojave për hapësira si dhe për të përkrahur bashkëpunimin.

### **Bashkëpunimi dhe koordinimi në nivel kantonial**

Nga ana e Drejtorisë arsimi HSKore përgjegjëse është Zyra e arsimit fillor për të koordinuar mësimin e -së dhe për ta përkrahur në aspektin administrativ. Nga ana e ofruesit, secili organ përgjegjës cakton një person i cili është përgjegjës për koordinim në nivel lokal e kantonial dhe bashkëpunon me Zyrën e arsimit fillor.

Dy komisione përkujdesen që të shkëmbehen informacione të rëndësishme, të sqarohen çështjet konceptuale dhe organizative si dhe të bisedohen aspektet pedagogjike. Këto janë "Konferenca e HSK-së" dhe "Komisioni i konferencës së HSK-së". Në konferencën e HSK-së janë të përfaqësuara organet përgjegjëse si dhe përfaqësuesit e strukturave të rregullta (nga një përfaqësues për mësuesit, drejtoritë e shkollave, mësuesit e gjermanishtes si gjuhë e dytë (GJsGJD) dhe të bordit të shkollave). Në mbledhjet e komisionit të HSK-së merr pjesë edhe shkolla e lartë pedagogjike e Cyrihut, e cila me detyrë të Drejtorisë arsimore organizon seminare për mësuesit e HSK-së. Në komisionin e Konferencës së HSK-së zënë nga një vend përfaqësueset dhe përfaqësuesit e organeve përgjegjëse të HSK-së.

Organet përgjegjëse të HSK-së i raportojnë rregullisht Zyrës së arsimit fillor mbi veprimtarinë e tyre. Për këtë ata u përgjigjen pyetjeve specifike dhe i dorëzojnë planet e tyre mësimore të përkthyer në gjermanisht si dhe dokumente të tjera.

# Shtojca II: Nivelet dhe temat – një vështrim i përgjithshëm

Kjo listë temash është menduar si përkrahje për planifikimin dhe përmbajtjen e mësimit. Ajo jep një vështrim se cilat tema në cilin nivel shkollor mund të trajtohen në mësimin e HSK-së. Ajo përfshin shumë propozime temash Për arsye të numrit të kufizuar të orëve, mësuesi duhet të bëjë vetë një përzgjedhje të tyre.

Temat janë edhe pjesë e Planit mësimor 21 dhe trajtohen në klasat e rregullta të shkollës fillore. Fusha e kompetencave që korrespondojnë me temat e Planit mësimor 21 janë të shtruar në listën e mëposhtme.

Tema

## Unë dhe të tjerët – jetojmë bashkërisht

Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.10](#) | [RKE.1](#) | [RKE.2](#) | [RKE.5](#)

### Cikli 1

- Njohim njëri-tjetrit; përshëndetemi, prezantohem (njëri-tjetrit)
- Format e mirësjelljes dhe rregullat e mirësjelljes; Kopshti parashkollor / shkolla: Rregullat, proceset dhe normat, ritualet
- Bërja ose përjetimi i diçkaje bashkërisht me të tjerët; shoqëria; çfarë mund të bëjë unë vetë

### Cikli 2

- Grupet dhe kulturat e ndryshme; rregulla dhe vlera të njëjta dhe të ndryshme, respekt i dyanshëm dhe njohje e ndërsjellë, konfliktet dhe strategjitë e zgjidhjes
- Kush jam unë: çfarë më bën të veçantë, ku bëj pjesë unë
- Rolet e gjinive: djemtë – vajzat
- Të drejtat e fëmijëve

### Cikli 3

- Individit dhe grupit, përkatësia dhe të qenit i huaj
- Bashkëjetesa e shumicës dhe pakicës: racizmi, debatet aktuale dhe ngjarjet
- Modele dhe idhuj: nga sporti, shkenca, kultura dhe historia
- Marrëdhëniet me gjininë e vetvetes dhe të të tjerëve (edhe pritshmëritë specifike kulturore)
- Të drejtat e njeriut

## Tema

### Familja

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.10](#) | [RKE.2](#) | [RKE.5](#)

#### Cikli 1

- Familja ime dhe farefisi; rregullat dhe normat në familje

#### Cikli 2

- Ndarja e punëve dhe detyrave në familje
- Historia e familjes sime: Gjeneratat dhe pema e familjes
- Format e ndryshme të familjeve

#### Cikli 3

- Rolet e anëtarëve të familjes: ndryshimi me kalimin e kohës, dallimet kulturore
- Të kuptuarit e rolit tim (të vetvetes)
- Funkzionet dhe format e familjes në varësi të historisë dhe kulturës
- Vlerat e mia; etika

## Tema

### Loja dhe koha e lirë

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.10](#) | [RKE.5](#)

#### Cikli 1

- Luajmë: së bashku, në vende të ndryshme, me gjëra të ndryshme të lojës; lojëra moderne dhe tradicionale dhe sendet e lojës
- Koha e lirë dhe hobit
- Veglat e punës dhe mjetet e punës

#### Cikli 2

- Të çlodhesh dhe të pushosh
- Organizimi i kohës së lirë; sporti; grupi i bashkëmoshatarëve; shoqatat
- Raporti me mediat dixhitale dhe të tjera
- Reklama

#### Cikli 3

- Të çlodhesh dhe të pushosh
- Organizimi i kohës së lirë; klubi i të rinjve; kultura rinore (muzika, gjuha); grupi i bashkëmoshatarëve; shoqatat
- Raporti me mediat dixhitale dhe të tjera
- Reklama

## Tema

### Banimi, rrethi dhe qyteti

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.8](#) | [RZG.3](#) | [RZG.4](#)

#### Cikli 1

- Mjedisi në kopshtin parashkollor / në shkollë
- Banesa jonë / shtëpia jonë dhe mjedisi ynë

#### Cikli 2

- Shtëpitë dhe banimi

#### Cikli 3

- Banimi dhe stilet e ndërtimit; zhvillimet historike

## Tema

### Festat, zakonet dhe moda

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.7](#) | [RZG.2](#)

#### Cikli 1

- Ditëlindja dhe festat e tjera të rëndësishme, format e ndryshme të festave
- Rrobat dhe rrobat e ndryshme në varësi të rastit

#### Cikli 2

- Festimi i ndryshëm i festave; traditat fetare
- Modelet e veshjeve në vazhden e kohës; veshjet sipas profesionit, rrobat dhe roli / statusi, mallra të markës

#### Cikli 3

- Kultura e daljes mbrëmjeve dhe festat
- Moda dhe ritualet në ndryshimet historike

## Tema

### Shëndeti dhe ushqimi

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.1](#) | [NT.7](#)

#### Cikli 1

- Trupi im dhe trupi i njeriut: pjesët e tij, integriteti trupor i imi dhe i të tjerëve; pesë shqisat
- Higjiena
- Përkujdesja mjekësore
- Ushqimi dhe pirja e shëndetshme, zakonet e të ngrënit

#### Cikli 2

- Shëndeti dhe sëmundja; mënyra e shëndetshme e jetesës
- Prej nga vjen ushqimi, perimet dhe pemët në varësi të stinës

#### Cikli 3

- Sporti; varshmëria
- Të ushqyerit; kultura të ndryshme ushqimore varësisht nga kultura, historia dhe mjedisi
- 

## Tema

### Gjeografia

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.8](#)

#### Cikli 1

- Emërtimet gjeografike nga përvoja e fëmijëve (vendbanimi, vendet e prejardhjes, Zvicra, vendi fqinj etj.); nocionet për orientim në hapësirë
- Vendi im i prejardhjes: Vështrim i përgjithshëm mbi gjeografinë, klima

#### Cikli 2

- Ujëra të rëndësishëm, malet dhe qytetet në vendet e prejardhjes

#### Cikli 3

- Karakteristikat gjeografike të rajoneve të vendeve të prejardhjes



## Tema

### Natyra dhe teknika

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.2](#) | [NMG.3](#) | [NMG.4](#) | [NT.1](#) | [NT.2](#) | [NT.8](#) | [NT.9](#)

#### Cikli 1

- Kafshët, kafshët shtëpiake; kafshët dhe bimët; pylli
- Pemët dhe perimet; katër elementet
- Stinët e vitit dhe ndryshimet në natyrë
- Nacionet për kohën (viti, muaji, java, dita, ora, mbrëmja, dreka, dje, sot, nesër etj.), koha
- Pajisjet shtëpiake
- Mjetet e transportit, të cilat fëmijët i përdorin vetë (biçikleta, skateboard, skuter etj.)

#### Cikli 2

- Llojet e kafshëve dhe llojet e bimëve
- Zinxhiri ushqimor
- Moti dhe parashikimi i motit
- Mbrojtja e mjedisit, katastrofat natyrore
- Lodrat dixhitale dhe mjetet e komunikimit

#### Cikli 3

- Ekologjia, rrezikimi dhe mbrojtja e mjedisit (ndër të tjera riciklimi dhe heqja e plehrave)
- Debatet aktuale nga fusha e shkencës (eksperimentet me kafshë, kërkimi gjenetik etj.)
- Lodrat dixhitale dhe mjetet e komunikimit

## Tema

### Letërsia dhe arti

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[Gjuhët](#)

#### Cikli 1

- Këngët; rimat dhe vargjet; përrallat; librat e ilustruar
- Ngjyrat; filmat
- Të krijosh vetë vepra dhe të flasësh me të tjerët për to

#### Cikli 2

- Poezitë, legjendat, fabulat; biblioteka ndërkulturore
- Filmat

#### Cikli 3

- Shembuj të letërsisë klasike dhe moderne
- Filmat
- Arti pamor, muzika dhe fusha të tjera të artit: artistët

## Tema

### E kaluara dhe historia

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.9](#) | [RZG.6](#) | [RZG.7](#) | [RZG.8](#) | [RKE.4](#)

#### Cikli 1

- "Kur isha i vogël"
- Dallimet mes të kaluarës – të sotmes
- Përjetime personale në vendet e prejardhjes: udhëtimet, pushimet

#### Cikli 2

- Historia e familjes sime; emigrimi
- Historia e vendeve të prejardhjes: Ngjarje të rëndësishme, mitet për prejardhjen

#### Cikli 3

- Biografia ime (p.sh. sa i përket mësimit ose gjuhëve)
- Zhvillimet aktuale sociale dhe politike në vendet e prejardhjes
- Besimet fetare dhe botëkuptimet
- Arsimimi politik (ndër të tjera zgjedhjet dhe votimet)

## Tema

### Fusha e punës dhe arsimimi

#### Lidhja e temës me Planin mësimor 21:

[NMG.6](#) | [WAH.1](#) | [WAH.2](#) | [WAH.3](#)

#### Cikli 1

- Profesionet e njerëzve nga mjedisi personal; profesionet në shkollë dhe në publik (fusha e gastronomisë, policia, spitali, shitja etj.)

#### Cikli 2

- Profesionet e ëndërruar; personalitete shembullore nga fushat e ndryshme të profesioneve
- Rëndësia e arsimimit dhe e punës

#### Cikli 3

- Zgjedhja e profesionit dhe kalimi në fushën e punës ose në një shkollë më të lartë në Zvicër dhe në vendet e prejardhjes: Profesionet dhe parakushtet, dallimet mes shteteve
- Profesionet dhe identiteti; përdorimi i aftësive dhe kompetencave ndërkulturore personale; çështje specifike gjinore
- Ekonomia: sektorë të ndryshëm, zhvillimi historik, papunësia, sindikatat

# Shtojca III: Literatura

**Kjo shtojcë përfshin literaturën e përmendur në këtë tekst. Një përzgjedhje më e gjerë e materialeve, literaturës dhe burimeve të tjera për përkrahjen në gjuhët e para ose shumëgjuhësinë mund të gjenden në faqen e internetit të Zyrës së arsimit fillor: [www.zh.ch/hsk](http://www.zh.ch/hsk)**

Departamenti i Zhvillimit të Arsimit Ndërkombëtar (International Projects in Education) i shkollës së lartë pedagogjike të Cyrihut (2018): Materialet për mësimin në gjuhën e prejdardhjes; Rreth përdorimit të dialektit dhe gjuhës standarde, Cyrih: Shkolla e lartë pedagogjike e Cyrihut.

Drejtorja arsimore e kantonit të Cyrihut (2017): Plani mësimor i Shkollës fillore i kantonit të Cyrihut.

Giudici, Anja und Bühlmann, Regina (2014): Mësimi në Gjuhën dhe Kulturën e Atdheut HSK. Një përzgjedhje e praktikave të mira në Zvicër, Bern: Sekretariati i Përgjithshëm KDE.



